



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 33/2022 regjistër (JR)

Datë 21.07.2022

Nr. 27 i vendimit

Datë 03.04.2025

**VENDIM**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Mimoza Tasi</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 03.04.2025, ditën e enjte, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Griselda Muça, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Elveta Stafa (Murra), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 534, datë 23.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elveta Stafa (Murra).

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenet 62, 63, 65 e vijues të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, sipas të cilave ajo kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 534, datë 23.05.2022, dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoji gjyqtaren relatores, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elveta Stafa (Murra), (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* në zbatim të nenit 179/b, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”).
  - 2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas të cilit: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin e e krijimit të pasurisë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
3. Komisioni përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar vetëm në një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar me masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra*, nëpërmjet vendimit objekt shqyrtimi me nr. 534, datë 23.05.2022. Arsyetimi i Komisionit përmbledhet në vijim.

#### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit nga detyra, u bazua në vlerësimin përfundimtar për kriterin e pasurisë dhe vlerësimin tërësor të çështjes, në zbatim të pikës 2, të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit *nuk* arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 për shkak se ka kryer deklarim të pasaktë të pasurive dhe të interesave private, dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj, si dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi dhe përdorim. Vlerësimi i mësipërm u bazua në konkluzionet përfundimtare se: (a) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime *kontradiktore* gjatë procesit administrativ, duke mos iu përgjigjur saktë pyetjeve të Komisionit lidhur me pasuritë; (b)

ka *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve për periudhën 2003 – 2016; (c) ka bërë deklaram të *pasaktë* lidhur me pasuritë e krijuara dhe burimin e ligjshëm; (ç) ka bërë deklaram të *rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm* për kriterin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016; (d) me veprimet dhe qëndrimet e saj, *ka cenuar besimin e publikut* në sistemin e drejtësisë, në kuptim të pikës 5, të nenit 61. të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit**

5. Subjekti i rivlerësimit, në datën 13.07.2022, ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit. Ajo pretendon se ka arritur në një nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, që kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë dhe nuk ndodhet në asnjë prej kriterëve të parashikuara në pikat 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe as në pikat 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, me referim nenin 33 të po këtij ligji. Gjetjet e Komisionit bien ndesh me dispozitat e sipërcituara, pasi subjekti nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme, nuk ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë, nuk ka bërë deklaram të rremë, nuk ka bërë fshehje të pasurisë, dhe nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit. Me pretendimin se procesi i hetimit dhe i vlerësimit bazuar vetëm në një kriter, përbën shkelje të rëndë të procedurës së rivlerësimit dhe se ka qenë një proces i zhvilluar nën doza të larta paragjykimi e me një standard të ndryshëm nga ai i mbajtur për subjektet e tjerë të rivlerësimit, në shkelje të parimit të barazisë përpara ligjit, subjekti kërkon që gjykimi i çështjes në Kolegj të bëhet në seancë *publike*, me qëllim vlerësimin e drejtë të provave, vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera, si edhe për t'i dhënë mundësinë të dëgjohet nga një Gjykatë, si një garanci e respektimit të procesit të rregullt ligjor, të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNj). Përfundimisht, subjekti i rivlerësimit i kërkon Kolegjit të vendosë, ndryshimin e vendimit nr. 534, datë 23.05.2022, dhe konfirmimin e saj në detyrë.
6. Në vijim të këtij vendimi, prezantohen në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit të grupuara në shkaqe me natyrë procedurale që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe në shkaqe që lidhen me themelin e çështjes e konkretisht, kundërshtime lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë.

#### ***III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale***

6.1. Prosesi i rivlerësimit për subjektin është kryer në shkelje të së drejtës kushtetuese dhe konventore për një proces të rregullt ligjor. Vlerësimi përfundimtar i subjektit, duke u bazuar vetëm në hetimin e një kriteri, përbën një shkelje të rëndë të nenit Ç, pika 1 të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016 dhe të nenit 6/1 të KEDNj-së.

6.2. Subjektit i është mohuar e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Komisioni është treguar subjektiv dhe i njëanshëm dhe ka vepruar në shkelje të parimit të barazisë përpara ligjit, pasi në procesin e zhvilluar ndaj saj ka përdorur një standard tjetër, të ndryshëm nga ai i mbajtur për të njëjtat rrethana, në proceset e zhvilluara ndaj subjekteve të tjerë të rivlerësimit. Vendimi i marrë ndaj subjektit është rezultat i një procesi të paracaktuar dhe të zhvilluar nën doza të larta paragjykimi. Pas dhënies së vendimit, subjekti është njohur me faktin se kryesuesja e trupit gjykues që ka shqyrtuar çështjen e saj, ishte marrë e pandehur nga Prokuroria e Posaçme, nën akuzën e veprave

penale të “Deklarimit të rremë” dhe të “Falsifikimit të dokumenteve”. Ky fakt mjafton për ta shpallur relativisht të pavlefshëm procesin e rivlerësimit të kryer ndaj subjektit.

6.3. Vendimi i Komisionit ka qenë i paragjykuar, i paracaktuar dhe rezultat i një procesi të zhvilluar në shkelje të parimit të barazisë së palëve dhe të kontradiktoritetit. Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumë prej argumenteve dhe provave të paraqitura prej saj, duke u mjaftuar vetëm në administrimin “formal” të provave të depozituara në seancën dëgjimore të datës 19 maj 2022, pa i bërë ato objekt të debatit gjyqësor. Kalimi i barrës së provës të subjekti i rivlerësimit dhe zhvillimi i seancës dëgjimore, janë bërë vetëm “në dukje”, me qëllim krijimin e bindjes të respektimit të procedurës ligjore, kur në fakt vendimi ishte marrë më parë. Ai (vendimi) është shpallur një ditë pas zhvillimit të seancës dëgjimore, çka i krijon bindjen se Komisioni nuk ka bërë vlerësim mbi pretendimet e potencuara pas kalimit të barrës së provës dhe shpjegimeve të dhëna gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### ***III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë***

6.4. Subjekti i rivlerësimit e kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë. Vendimi i Komisionit është i pambështetur në parashikimet ligjore që normojnë këtë proces. Pasaktësitë në deklaratimet e subjektit nuk dëshmojnë përpjekje për të fshehur apo për të paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi apo përdorim. Për rrjedhojë, këto konstatime nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë, pasi bien ndesh me pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, me referim nenin 33 të po këtij ligji, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku.

6.5. Përfundimet e Komisionit për deklaram të pamjaftueshëm bien ndesh me përfundimin e ILDKPKI-së. Konkluzionet e Komisionit për deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm dhe të paprovuar me dokumentacion, janë të hamendësuara dhe të gabuara. Ato nuk janë rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë e të paanshëm të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, provave të paraqitura pas kalimit të barrës së provës si dhe provave të administruara nga vetë Komisioni gjatë këtij procesi.

6.6. Për *apartamentin* në qytetin e Elbasanit, subjekti potencon se ka pasur aftësi pagueese për blerjen e tij, në shumën 4.2 milionë lekë të likuiduar në vitin 2008 -- me të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortit, të ardhurat nga shitja e vreshtit, dhe në shumën 1.3 milionë lekë të likuiduar në vitin 2009 -- me të ardhurat nga puna e subjektit dhe bashkëshortit dhe të ardhurat e nga shitja e apartamentit tjetër në Elbasan, me vendndodhje në lagjen “{\*\*\*}”.

6.6.1. *Shuma 4.200.000 lekë*, përfituar nga shitja e vreshtit është e ardhur e ligjshme. Ajo ka vërtetuar se këto të ardhura janë përfituar në bazë të marrëveshjes të vitit 2009, të lidhur midis bashkëshortit të saj dhe blerësit, i cili që nga viti 2009 e gëzon këtë pasuri pavarësisht mosformalizimit të veprimit në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për shkak të problemeve administrative. Likuidimi i detyrimeve tatimore do të bëhet në momentin e shitjes, sapo të bëhet e mundur nxjerrja e këtyre dokumenteve të pronësisë. Për sa më sipër, kjo e ardhur duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm e të përfshihet në analizën financiare për krijimin e pasurisë apartament 3+1.

6.6.2. Shuma prej 2.200.000 lekësh, e arkëtuar në datën 14.05.2008 në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nga blerësi (z. B. P.), përfaqëson parapagimin e vlerës së përcaktuar në kontratën e datës 05.05.2009. Kjo shumë e tërhequr në datën 01.08.2008, nuk duhet konsideruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2008.

6.7. Për sa i përket *apartamentit me sipërfaqe 59.78 m<sup>2</sup>, në qytetin e Pogradecit, me vlerë 2.2 milionë lekë*, subjekti pretendon se ka pasur aftësi paguese për blerjen e tij, përkatësisht në shumën 2 milionë lekë të likuiduar në vitin 2010, me burim gjendjen monetare të fillimvitit 2010 dhe të ardhurat nga shitja në vitin 2010 e garsonieres me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup> në Pogradec, si edhe në shumën 200.000 lekë të paguar në vitin 2011, me burim likuiditetet monetare tepriçë të fillimvitit 2011. Sipas subjektit, blerja e kësaj pasurie është revokuar me aktmarrëveshjen e datës 30.01.2020, lidhur me shitësin/pronarin e truallit A. B., i cili u ka kthyer edhe vlerat e parapaguara prej 2.2 milionë lekësh. Subjekti potencon se ka pasur aftësi paguese për blerjen e garsonieres në vitin 2004, kundrejt çmimit 700.000 lekë, me të ardhurat e realizuara në vitin 2006 nga shitja e automjetit “Fiat Croma” dhe të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në vitin 1996. Për rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie duhet të konsiderohen të ligjshme dhe të përfshihen në analizën financiare në funksion të krijimit të apartamentit me sipërfaqe 59.78 m<sup>2</sup>.

6.8. Konstatimi i Komisionit *për blerjen lirë dhe shitjen shtrenjtë të automjeteve nga bashkëshorti i saj*, është i gabuar dhe i pambështetur në prova. Veprimet e kryera me familjarë shumë të afërt të subjektit, justifikojnë çmimin e lirë të blerjes së tyre. Në kushtet e ekonomisë së lirë të tregut, subjekti nuk mund të penalizohet nga shitja më shtrenjtë e një sendi të luajtshëm të mirëmbajtur. Subjekti pretendon se noteri ku janë kryer veprimet, nuk kryen transferimin e pronës pa paguar *tatimin*, që do të thotë se detyrimet tatimore janë shlyer, pavarësisht se subjekti nuk disponon mandatin e pagesës së tatimit.

6.9. Subjekti kundërshton metodologjinë e Komisionit për shtesat dhe pakësimet e *likuiditeteve* gjendje *cash* në shtëpi për periudhën e deklaramit, nga viti 2003 deri në vitin 2017, duke u bazuar në të dhënat e deklaruara “me hamendje” nga ana e subjektit. Kjo metodologji e ka bërë analizën të pasaktë dhe ka denaturuar rezultatin financiar dhe burimin e mbulimit të shpenzimeve me të ardhura në disa vite. Llogaritja e këtyre likuiditeteve duhej bazuar në gjendjen e deklaruar në ILDKPKI, në datën 01.01.2003, duke mbledhur të ardhurat e dokumentuara për çdo vit, dhe zbritur pagesat e dokumentuara dhe shpenzime të tjera. Gjendja e mbetur në fund do të tregonte mjetet monetare që subjekti ka deklaruar në bankë dhe në shtëpi.

6.10. Konkluzioni i Komisionit *për mosdeklarimin e kredisë* në shumën 280.000 lekë, marrë nga djali i subjektit në vitin 2014, është i pavërtetë. Dokumentacioni vërteton se mosdeklarimi i kësaj kredie është një harresë e subjektit gjatë procesit të plotësimit të deklaratës periodike, e cila është korrigjuar nga subjekti më datën 02.03.2016, gjatë kontrollit periodik në ILDKPKI.

6.11. Sipas subjektit, *analiza financiare* është hartuar në kundërshtim me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i cili ngarkon ILDKPKI-në për kryerjen e kontrollit të hollësishëm të pasurive dhe ligjshmërinë e burimeve të tyre. Komisioni ka vepruar në shkelje të parimit të kontradiktoritetit, pasi analiza financiare nuk i është nënshtruar debatit dhe krahasimit me analizën financiare të hartuar nga audituesi ligjor i pajtuar prej saj, dhe depozituar me prapësimet kundër rezultateve të hetimit. Vendimi është i paragjykuar dhe i paarsyetuar, pasi Komisioni nuk arsyeton pse nuk e ka bërë analizën financiare për të gjitha vitet e

deklarimit të lidhura me njëra tjetrën, për të ardhura të ligjshme, sipas metodologjisë së përdorur nga ILDKPKI. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të vërtetojë të ardhurat e ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të saj. Balanca negative është rrjedhojë e mospërfshirjes së të gjitha të ardhurave dhe pasurive të krijuara nga njëra anë, dhe përfshirjes në mënyrë të padrejtë si shpenzime, i disa vlerave që në fakt nuk përbëjnë shpenzim.

6.12. Subjekti i kërkon Kolegjit edhe të përfshijë në analizë sa vijon:

6.12.1. Të ardhurat neto të periudhës 1993 – 2002 nga ekonomia bujqësore familjare mbi tokën “vresht”, të cilat sipas akt vlerësimit janë 1.368.180 lekë<sup>1</sup> për periudhën 1993 – 2002 dhe 152.020 lekë në çdo vit, për periudhën në vijim.

6.12.2. Shumën 4.200.000 lekë, nga shitja e vreshtit, në bazë të marrëveshjes të vitit 2009.

6.12.3. Të ardhurat e bashkëshortit nga avokatia, në shumat 2.584.800 lekë, të realizuara në secilin vit, 2012 e 2013, sipas shkresës datë 21.07.2017, të Bashkisë Elbasan, drejtuar ILDKPKI-së dhe jo në shumat 258.480 lekë të pasqyruar për këto dy vite në shkresën e Bashkisë Elbasan datë 21.02.2022.

6.12.4. Të ardhurat faktike nga shitja e dy automjeteve “Mercedes-Benz”, përkatësisht në shumat 450.000 lekë dhe 900.000 lekë, sipas kontratave të shitjes, dhe jo siç i ka llogaritur Komisioni në vlerat e blerjes, 200.000 lekë dhe 1500 euro.

6.12.5. Shumën 2.200.000 lekë, arkëtuar në datën 14.05.2008 në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nga blerësi B. P., e cila përfaqëson parapagimin e vlerës së përcaktuar në kontratën e datës 05.05.2009. Kjo shumë, e tërhequr në datën 01.08.2008, duhet konsideruar në analizë financiare si e ardhur dhe jo si shpenzim.

6.12.6. Në analizën financiare të vitit 2016, nuk duhen përfshirë si zë më vete shpenzimet e kryera për blerje me kartë brenda dhe jashtë vendit në shumën 112.668 lekë, pasi janë për artikuj ushqimorë e veshmbathje të cilët janë të përfshirë në zërat e konsumit familjar sipas INSTAT-it.

6.12.7. Disa të ardhura të pallogaritura nga Komisioni e konkretisht: (i) shuma 68.250 lekë, nga punësimi i bashkëshortit të subjektit në ish-ndërmarrjen NB Elbasan për periudhën 15.04.1985 – 31.05.1993; (ii) paga e subjektit të rivlerësimit për periudhën 01.03.1993 – 15.09.1995 nga puna si hetuese në Hetuesinë Rrethit Elbasan; (iii) paga e subjektit të rivlerësimit në shumën 21.350 lekë, nga punësimi si prokurorë në periudhën 1990 – 1993.

#### **IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit**

##### ***A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj***

###### *A/i. Juridiksioni i Kolegjit*

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja

---

<sup>1</sup>9 vjet x 152.020 lekë.

me objekt shqyrtimi kundërshtimin e vendimit të Komisionit, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit. Trupi gjykues i Kolegjit, me përbërjen si në pjesën hyrëse të këtij vendimi, është rezultat i shortit të zhvilluar në datën 28.07.2022, i cili është publikuar në internet, në faqen zyrtare të Kolegjit<sup>2</sup>.

*A/ii. Legjitimimi i ankueses*

8. Ankuesja legjitimohet *ratione personae*, duke qenë subjekt rivlerësimi në kuptim të dispozitave kushtetuese e ligjore që rregullojnë këtë aspekt, dhe *ratione temporis*, në kushtet që ankimi është depozituar pranë Komisionit në datën 13.07.2022, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar<sup>3</sup>, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

*A/iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelit*

9. Trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin në *dhomë këshillimi*, nën dritën e pikës 1, të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012<sup>4</sup>, referuar nga neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Pasi analizoi kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor, administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit dhe vazhdimin e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj<sup>5</sup>, që do të diktonin nevojën për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, në praninë e subjektit. Ky vlerësim përfshin analizën e kryer qoftë për shkaqet procedurale apo edhe atë të vlerësimit të rrethanave faktike, përcaktuar nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012. Konkretisht, subjekti nuk ka depozituar prova të reja që lejohen me ankimin në kuptim të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por ka pretenduar shkelje të rënda procedurale dhe nevojën për shqyrtim të akteve që administrohen në dosjen e Komisionit. Nga vlerësimi i konkluzioneve të Komisionit dhe i pretendimeve në ankim të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit nuk evidentoi asnjë shkelje të rëndë procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, që do të passillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegji, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

*B.1. Analiza e shkaqeve të ankimit me natyrë procedurale*

10. Sikurse referuar më sipër në paragrafët 6.1 deri në 6.3, shkaqet e ankimit me natyrë procedurale përmbledhen në pretendimin e subjektit për shkelje e të drejtave kushtetuese e konventore për proces të rregullt nga Komisioni në rivlerësimin e saj meqenëse: (i) është rivlerësuar vetëm për një kriter; (ii) procesi ka qenë i paragjykuar, i paracaktuar dhe është zhvilluar në shkelje të parimeve të barazisë përpara ligjit dhe të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme; kryesuesja është hetuar e

<sup>2</sup> <https://kpa.al/njoftim-878/> dhe <https://kpa.al/njoftim-1481/>.

<sup>3</sup> Vendimi i arsyetuar i është nisur subjektit të rivlerësimit në datën 30.06.2022. Ajo ka marrë djeni në datën 05.07.2022.

<sup>4</sup> Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

<sup>5</sup> Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: "[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së parë. [...]".

proceduar për dy vepra penale; (iii) Komisioni ka zbatuar një standard të dyfishtë, të ndryshëm nga ai i mbajtur për të njëjtat rrethana në çështjen e saj; (iv) vendimi objekt ankimi, është rezultat i një procesi të paracaktuar dhe të zhvilluar nën doza të larta paragjykimi, pasi nuk është respektuar parimi i barazisë së palëve dhe i kontradiktoritetit, nuk janë marrë në konsideratë argumentet dhe provat e paraqitura prej saj, dhe veprimet kanë qenë formale.

**10.1.** Nga analiza e akteve në fashikull nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky grup pretendimesh rezulton i pabazuar. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit, është kryer në respektim të parimeve të së drejtës dhe rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 6 të KEDNj-së, kuadrin ligjor të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ligjet që referohen në të. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

**10.2.** Pretendimi që argumenton se vlerësimi bazuar vetëm në një kriter vlerësimi përbën shkelje të rëndë procedurale, është i pambështetur. Përpos që rivlerësimi i bazuar vetëm mbi një kriter parashikohet shprehimisht në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar, pretendime të kësaj natyre kanë gjetur përgjigje shteruese, të përsëritura dhe të konsoliduara të Kolegjit në jurisprudencën e tij<sup>6</sup>. Po ashtu, në kushtet që ky pretendim ka kaluar edhe kontrollin për përputhjen me garancitë konventore, në vendimin kyç të GjEDNj-së “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, 14 muaj përpara ankimit objekt shqyrtimi në këtë vendim<sup>7</sup>, trupi gjykues gjen të panevojshme të ndalet në këtë kërkim përpos rikonfirmimit të sa është arsyetuar në një numër tejet të konsiderueshëm arsyetimesh. Sikurse arsyetuar gjerësisht, trupi gjykues çmon të rikonfirmojë që vlerësimi i një kriteri të vetëm është në përputhje me nenin 4, pika 2 të ligjit nr. 84/2016<sup>8</sup> ndërsa vlerësimi i të tria kriterëve dhe kalimi me sukses i secilit prej tyre është kërkesë që kushtëzon *konfirmimin* në detyrë sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtyre dispozitave, Komisioni dhe Kolegji mund të përfundojnë rivlerësimin qoftë edhe për vetëm njërin nga kriteret e vlerësimit.

**10.3.** Përpos pabazueshmërisë në dispozitat ligjore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim nuk gjen mbështetje as në aktet që administrohen në dosjen e Komisionit. Prej tyre, rezulton se Komisioni ka nisur hetimin administrativ për të tria kriteret e vlerësimit dhe pasi u njoh me rezultatet e hetimit paraprak të vlerësimit të pasurisë, doli në përfundimin se provat kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe se vlerësimi i subjektit të rivlerësimit mund të bëhej edhe vetëm për këtë kriter. Në këto kushte, Komisioni vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, bazuar vetëm në kriterin e kontrollit të pasurisë, duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për këtë kriter vlerësimi. Nga ana tjetër, ndonëse subjekti është njohur me faktin se po vlerësohet vetëm për kriterin e pasurisë<sup>9</sup>, nuk rezulton të ketë kundërshtuar vendimin e Komisionit për përfundimin e hetimit administrativ bazuar

<sup>6</sup> Vendimet nr. 3/2018 (JR), datë 17.07.2018, paragrafi 16 që i përket subjektit F. L.; nr. 6/2018 (JR), datë 12.09.2018, paragrafi 17, i subjektit B. N.; nr. 11/2018 (JR) datë 22.11.2018, kreu IV, pika 5, i subjektit T. N.; nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019, paragrafi 118, i subjektit D. Rr.; nr. 23/2019 (JR), datë 23.09.2019, pika 21, i subjektit A. L. etj.

<sup>7</sup>Konkretisht, vendimi i GjEDNj-së në “Xhoxhaj kundër Shqipërisë” ka hyrë në fuqi në 31.05.2021, ndërsa qoftë vendimi objekt ankimi i Komisionit, ashtu edhe ankimi objekt shqyrtimi, janë marrë dhe përcjellë një vit më pas, përkatësisht datat 23.05.2022 dhe 13.07.2022, ose 12 dhe 14 muaj më pas.

<sup>8</sup>“[...] Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”.

<sup>9</sup> Email, datë 17.03.2022 me lëndë “Njoftim për njohjen me rezultatet e hetimit administrativ dhe dokumentet e dosjes së procedurës së rivlerësimit”, përmes të cilit Komisioni komunikon përfundimin e hetimit kryesisht, mbështetur në gjetjet e konstatuara për kriterin e pasurisë, si edhe rezultatet e hetimit, duke u bazuar në gjetjet për kriterin e pasurisë.

vetëm mbi këtë kriter. Madje, subjekti nuk ka ngritur pretendime për vlerësimin vetëm mbi një kriter, as në këtë moment procedural, as në parashtrimet e dërguara kundër rezultateve të hetimit<sup>10</sup> dhe as në seancë dëgjimore. Me parashtrimet kundër rezultateve të hetimit dhe në seancën dëgjimore të datës 19.05.2023, subjekti ka kërkuar riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë, ndërsa çeljen e hetimit për dy kriteret e tjera ia ka kërkuar Komisionit nëse do të krijonte bindjen se kalon testin e besueshmërisë për kriterin e pasurisë.

**10.4.** Nga sa më sipër, rezulton jo vetëm se për herë të parë ky pretendim ngrihet vetëm me ankimin, por edhe që vetë subjekti ka qenë e ndërgjegjshme që kalimi me sukses i kontrollit të kriterit të pasurisë ishte kusht për të vijuar vlerësimin e dy kriterëve të tjera. Kjo ka qenë edhe arsyeja për të cilën pretendimet e saj janë fokusuar në kundërshtimin e rezultatit negativ për këtë kriter. Në kushtet që në përfundim të procesit të rivlerësimit, ka rezultuar se subjekti dështoi të provonte me dokumentacion të kundërtën e rezultateve të hetimit edhe për të vetmin kriter për të cilin i kishte kaluar barra e provës, Komisioni nuk kishte shkak ligjor të çelte hetimin për kriteret e tjera, sikundër pretendon subjekti. Në këto kushte, nën dritën e parashikimit të shprehur të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si edhe në zbatim të parimit të eficiencës, të parashikuar nga neni 18 i ligjit nr. 44/2015<sup>11</sup>, si një nga parimet mbi të cilat duhet të funksionojë edhe Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i cili është një organ me tipare administrative, kryerja e hetimeve shtesë për komponentët e tjerë do ishte krejt e panevojshme, pasi në çfarëdo versioni të rezultonte, nuk do të sillte asnjë ndryshim në vendimmarrjen e Komisionit, për sa kohë që subjekti paraqitej me probleme në të vetmin kriter për të cilin ishte hetuar.

**10.5.** Në përgjigje të pretendimit të subjektit, se vendimi i marrë ndaj saj është rezultat i një procesi të paragykuar, në shkelje të barazisë përpara ligjit dhe të drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, dhe duke abstraguar nga fakti që subjekti nuk argumenton se cilat janë motivet konkrete që kanë diktuar paragykimin e çështjes dhe paracaktimin e vendimit që do të merrej ndaj saj, për shkak të rëndësisë që kanë parimet që garantojnë një proces të rregullt ligjor, trupi gjykues i Kolegjit, në vijim çmoi të ndalet në analizën e rrethanave të referuara e përmbledhura në paragrafët 6.1 - 6.3 dhe 10 për procesin e kryer ndaj saj nga Komisioni.

**10.6.** Në përgjigje të pretendimit se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë shumë nga argumentet dhe provat e paraqitura nga ankuesi në kuadër të barrës së provës, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se arsyetimi ndryshe apo në të kundërt i argumenteve dhe provave të paraqitura nga subjekti, nuk e bën procesin e rivlerësimit të paragykuar. Vlerësimi i provave bëhet nën dritën e pikës 4, të nenit 49<sup>12</sup> të ligjit nr.84/2016 dhe nenit 81<sup>13</sup> të Kodit të Procedurës Administrative. Në raport me këto kërkesa ligjore, vlerësimi i Komisionit jo domosdoshmërisht duhet të konfirmojë argumentet dhe qëndrimin e subjektit

---

<sup>10</sup> Në parashtrimet e dërguara më datë 31.03.2022 subjekti shprehet literalisht: “Nëse unë, me këto pasuri nuk e meritoj të konfirmohem në detyrë, nëse Ju do ta vlerësoni kështu, do të pranoj verdiktin Tuaj, por nëse do të jeni të drejtë dhe të ftohtë në analizën dhe konkluzionin Tuaj, do t’ju kërkoja të riçelni hetimin, si dhe të çelni hetimin edhe për dy kriteret e tjera, atë profesional dhe të pastërtisë së figurës.

<sup>11</sup> Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.

<sup>12</sup> Neni 49 pika 4 i ligjit nr.84/2016 parashikon: “[...] Komisioni dhe Kolegji i Apelit i bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes [...]

<sup>13</sup> Neni 81 i K. Pr. Administrative parashikon: “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishtëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatit tërësor të hetimit administrative [...]”.

për çështje të caktuara dhe në këtë kuptim, nuk nënkupton mungesë të analizimit e vlerësimit të provave dhe as subjektivizëm, por një analizë ndryshe, që ka prodhuar një konkluzion të ndryshëm nga qëndrimi i subjektit. Qëndrimi ndryshe, nuk e bën Komisionin subjektiv, të njëanshëm dhe as paragjykes në vendimmarrjen e tij. Ky pretendim përveçse jo domethënës, rezulton edhe i pavërtetë referuar vendimit objekt ankimi, në të cilin nuk vërehet i shprehur e as me kontekst të nënkuptuar, ndonjë element paragjykes i Komisionit. Vendimi i Komisionit përmban një analizë të plotë e adekuate të provave të administruara gjatë hetimit, përfshirë ato të marra nga vetë Komisioni, ashtu edhe atyre të sjella nga vetë subjekti i rivlerësimit.

**10.7.** Po ashtu, kalimi i barrës së provës dhe zhvillimi i seancës dëgjimore, ndryshe nga sa pretendon subjekti, nuk rezultojnë të jenë kryer në mënyrë “formale” apo vetëm “në dukje”, sikurse as nuk deduktohet që vendimi të ketë qenë “marrë më parë”. Shpallja e vendimit një ditë pas seancës dëgjimore, nuk mund të nënkuptojë mungesë vlerësimi për pretendimet dhe shpjegimet gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore. Aktet në dosje vërtetojnë të kundërtën. Konkretisht, së pari, mes dërgimit të prapësimeve të rezultateve të hetimit nga subjekti dhe seancës dëgjimore kanë kaluar mbi gjashtë javë, nga 31 marsi deri në 19 maj 2022. Në këtë periudhë, Komisioni ka shtyrë tri seanca dëgjimore, për të akomoduar kërkimet e përfaqësuesve ligjorë të subjektit. Për rrjedhojë, edhe vetëm nga kohëzgjatja e këtij hapi procedural, rezulton qartë se nuk mund të argumentohet që Komisioni nuk ka pasur kohë të mjaftueshme që të njihej me shpjegimet e subjektit. Së dyti, referuar procesverbalit të seancës dëgjimore, Komisioni ka njoftuar subjektin se të gjitha provat do të vlerësoheshin para vendimmarrjes së çështjes dhe vendimi i Komisionit i është referuar akteve në mënyrë të shprehur. Ndër të tjera: (i) dokumentacionit nga kampi i azilkërkuesve për djalin e subjektit, mbi bazën e të cilit Komisioni rishikoi shpenzimet e tij të qëndrimit jashtë Shqipërisë gjatë kësaj periudhe; (ii) analizën që i bëhet kontratës së datës 08.08.2006 për shitjen e automjetit, të cilën Komisioni e vlerësoi si ndryshim të deklarimit të burimit të krijimit të garsonieres në Pogradec; (iii) vlerësimin e aktmarrëveshjes së premtim shitjes të pasurisë “vresht”, në datën 29.12.2009, dhe arsytimit përkatës për mungesën e vlerës provuese të saj dhe shkaqet; (iv) dokumentacioni i sjellë me prapësimet e datës 31.03.2022, si pasojë e të cilit janë përfshirë në analizën financiare të ardhurat e saj si hetuese në Prokurorinë e Rrethit Elbasan për vitet 1993 – 1995.

**10.8.** Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky pretendim është ngritur formalisht në ankim. Nga ana tjetër, dhe përpos këtyre aspekteve, nëse subjekti do të kishte pasur realisht dyshime se Komisioni po tregohej paragjykes që në nisje të procesit duke ia kaluar vetëm “në dukje” barrën e provës, kishte të drejtën ta parashtronte këtë pretendim qoftë gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve, qoftë në përfundim të hetimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, apo edhe në seancë dëgjimore. Në asnjë prej këtyre momenteve proceduralë, nuk rezulton që subjekti të ketë ngritur pretendime të kësaj natyre.

**10.9.** I pavërtetë rezulton edhe pretendimi se Komisioni në vendim ka ndryshuar rezultatin paraprak të hetimit duke konstatuar për deklarim të rremë. Faza “subjekti nuk ka kryer deklarim të rremë”, është konkluzioni i ILDKPKI-së cituar nga Komisioni qoftë në rezultatet e hetimit, ashtu edhe në vendim. Nga ana tjetër, përdorimi i këtij cilësimi në vendim vetëm në konkluzionin përfundimtar në faqen e parafundit të vendimit, pa asnjë referencë në trupin e vendimit, i palidhur me asnjë prej deklarimeve e pasurive, duhet të prezumohet si një gabim material ose një kapërcim nga pasaktësia në deklarim referuar germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për aspektet përkatëse. Nga ana tjetër, trupi

gjykues i Kolegjit çmon se, nëse konkluzioni i Komisionit për deklarim të rremë është deduksion i deklarimeve kontradiktore të subjektit të shtjelluara në vijim, subjekti është njohur me këto gjetje dhe ka dhënë shpjegime. Ndërsa në rezultatet e hetimit, Komisioni nuk mund të shprehë kualifikimin ligjor, nga barra e provës subjekti i rivlerësimit ka qenë e qartë për faktin që deklarimet e saj, thuajse në çdo pasuri të ankimuar, ishin kontradiktore sikurse edhe për faktin që ka paraqitur dy akte të ndryshme për kredinë e të birit.

**10.10.** Për sa më sipër, Komisioni nuk i ka ndryshuar rezultatet e hetimit dhe ky pretendim i subjektit mbetet i pavërtetë. Nga ana tjetër, sikurse shtjellohet në vijim, trupi gjykues i Kolegjit i vlerësoi kontradiktat e theksuara të deklarimeve të subjektit në funksion të kriterit të pasurisë dhe konfirmoi gjendjen e subjektit të rivlerësimit vetëm në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm. Konstatimi për cenim të besimit të publikut dhe deklarimi i rremë, nuk u konfirmuan në Kolegji. Për rrjedhojë, për shkak të korrektimit të kryer në Kolegji, mungesa e arsytimit të Komisionit, edhe parë nën këtë drejtim, nuk e bën të cënueshëm vendimin në tërësinë e tij dhe as procesin e rivlerësimit, jo ligjor.

**10.11.** Pretendimi se procesi ka qenë i paragjykuar apo se Komisioni ka përdorur një standard të ndryshëm për subjektin, krahasuar me të tjerë subjekte të rivlerësimit, është i pabazuar. Çdo çështje e juridiksionit të rivlerësimit paraqet faktet, rrethanat dhe veçoritë specifike të cilat nuk mund të jenë identike me rastin e saj. Për më tepër, vendimet e Komisionit i nënshtrohen kontrollit të Kolegjit dhe nuk përbëjnë jurisprudencë të unifikuar edhe nëse ato marrin formë të prerë.

**10.12.** Së fundmi, pretendimi i subjektit për cenim të procesit të kryer për të, dhe kërkimi që ai të shpallet i pavlefshëm për shkak të akuzës penale në ngarkim të Komisioneres Ç., është i pabazuar. Së pari, në periudhën e ndërmjetme, kjo çështje është zgjidhur nga gjykatat e dy shkallëve, dhe Komisionerja është deklaruar e pafajshme<sup>14</sup> për të dyja akuzat. Së dyti, dhe si *obiter dictum*, trupi gjykues sjell në vëmendje që edhe nëse do të pranohej hipotetikusht si argument hetimi gjatë kohës kur nuk kishte ende vendimmarrje nga gjykatat, në kushtet që vendimi i Komisionit iu nënshtroa kontrollit shterues të kryer në Kolegji, të shtjelluar në detaj në këtë arsyetim në vijim, ky pretendim nuk mund të argumentohet i një peshe që do të cenonte procesin në tërësi, për shkak të mungesës edhe teorikusht të një lidhjeje të mundshme shkakësore mes vendimmarrjes së Komisionit dhe veprimeve të cilat i janë nënshtuar hetimit penal<sup>15</sup>.

**10.13.** Në konkluzion të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për subjektin në përputhje me parimet e barazisë së armëve, të kontradiktoritetit dhe të drejtës për t'u dëgjuar e mbrojtur. Komisioni ka dërguar dhe subjekti i është përgjigjur tre (3) pyetësorëve me shpjegimet e veta, shoqëruar me dokumentacionin që është administruar dhe analizuar. Po kështu, subjekti është njohur dhe ka ushtruar të drejtat e saj në vijim të njohjes me rezultatet e hetimit administrativ. Afatet e njoftimit kanë qenë të arsyeshme. Përpos shpjegimeve e provave të depozituara për këtë qëllim, ajo ka depozituar akte edhe gjatë seancës dëgjimore të datës 19 maj 2022, sikurse

---

<sup>14</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.09.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, lënë në fuqi me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 12.01.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

<sup>15</sup> Shih ndër të tjera edhe arsyetimin e Kolegjit në çështjen e kërkesës për rishikim të znj. R. G., në [https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi\\_R.\\_G.\\_perفشire\\_mendimin\\_paralel\\_anonimizuar.docx-1.pdf](https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendimi_R._G._perفشire_mendimin_paralel_anonimizuar.docx-1.pdf).

konfirmohet nga procesverbali i mbajtur. Nga përmbajtja e vendimit objekt shqyrtimi, rezulton se Komisioni i ka analizuar pretendimet dhe provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjithë procesit. Subjekti ka ushtruar të gjitha garancitë për t'u mbrojtur e dëgjuar. Komunikimet dhe njoftimet janë kryer në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 84/2016. Pas tri (3) shtyrjeve radhazi të seancës dëgjimore me kërkesë të saj<sup>16</sup>, në garanci të procesit të rregullt ligjor, subjekti është dëgjuar dhe ka dhënë shpjegimet e veta në seancën dëgjimore të datës 19 maj 2022.

## *B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë*

### *B.2.1. Shkaqe të përgjithshme që lidhen me aspektin procedural e ligjor të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë*

11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se e kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurisë. Vendimi i Komisionit për kriterin e pasurisë është i pambështetur në parashikimet ligjore që normojnë këtë proces. Subjekti potencon se: (i) përfundimet e Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm, bien ndesh me përfundimin e ILDKPKI-së, sipas të cilit subjekti nuk ka kryer fshehje të pasurisë, nuk ka kryer deklarim të rremë dhe nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave; (ii) konkluzionet e Komisionit janë të gabuara dhe rrjedhojë e një vlerësimi jo të drejtë e jo të paanshëm i shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, i provave të paraqitura pas kalimit të barrës së provës dhe i akteve të administruara nga vetë Komisioni gjatë këtij procesi; (iii) gjetjet e Komisionit për kriterin e vlerësimit të pasurisë nuk janë të sakta, dhe në kushtet ku ka rezultuar e provuar se subjekti nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme, ato nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi bien ndesh me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30, 32 dhe pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku.

11.1. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe ky grup pretendimesh është i pambështetur në ligj dhe në akte. Komisioni dhe Kolegji janë organe të pavarura<sup>17</sup> dhe kryejnë hetimin e tyre, duke mos qenë të lidhur me konkluzionet e parashtruara në raportet e organeve ndihmëse, ILDKPKI, KLP apo Grupi i Punës së DSIK-së, sikurse rezulton qartë nga nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016. Në të kundërtën, procesi i rivlerësimit do të ishte një konfirmim formal i raporteve të organeve ndihmëse, e përmbledhje e tyre. Për më tepër, kjo çështje ka gjetur arsyetim tashmë të përsëritur, shterues e të konsoliduar qoftë në vendime të mëparshme të Kolegjit, i është nënshtruar kontrollit të kushtetutshmërisë nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 2/2017, elaboruar nga Komisioni i Venecias dhe konfirmuar edhe nga GjEDNj-ja në çështjen kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”. Për pasojë, trupi gjykues e çmon të panevojshme të ndalet sërish në këtë pikë duke konfirmuar se e gjen këtë pretendim tërësisht të pabazuar

<sup>16</sup> Në seancën e datës 05.04.2022, subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit personalisht, por u përfaqësua nga z. K. M., i cili kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore për t'u njohur me materialet e çështjes, për shkak të kohës të shkurtër nga emërimi me prokurë vetëm një ditë përpara seancës dëgjimore. Kjo kërkesë është pranuar nga Komisioni. Seanca e radhës, e datës 22.04.2022, u shty sërish në bazë të kërkesës së përfaqësuesit ligjor të subjektit të rivlerësimit për pamundësi pjesëmarrje për shkaqe shëndetësore. Edhe seanca dëgjimore e datës 28.04.2022 nuk u zhvillua, pasi Komisioni u vu në dijeni se si subjekti ashtu edhe përfaqësuesi kishin rezultuar të prekur nga virusi Covid 19.

<sup>17</sup> Neni 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

dhe të tejkaluar. Pretendimi tjetër i këtij grupimi është trajtuar më sipër dhe në arsyetimin në vijim për themelin e shkaqeve të ankimit për pasurinë.

11.2. Situata e fundit që potencohet me këtë grup pretendimesh, lidhet me këndvështrimin e subjektit të rivlerësimit për konceptin e “dyfishit të pasurisë së ligjshme”. Sipas saj, meqenëse subjekti nuk ka deklaruar dyfishin e pasurisë së ligjshme, gjetjet e Komisionit nuk mund të përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, pasi bien ndesh me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 30, 32 dhe pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, në një interpretim sistematik e logjik të këtyre dispozitave të para së bashku. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është i njëjtë me atë të ngritur nga një numër i konsiderueshëm subjektësh rivlerësimi, i cili tashmë është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit ndër vite<sup>18</sup>. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit, në rikonfirmim të qëndrimit të mbajtur edhe në vendime të tjera, vlerëson edhe në këtë rast, se pretendimi i subjektit është i pabazuar në ligj. Shkaqet që passjellin marrjen e masës disiplinore janë autonome dhe jo të kushtëzuara nga njëra-tjetra. Kjo duket qartë edhe nga fakti që nene të ndryshme të Aneksit të Kushtetutës përkrijnë me nënpjesë e situata të përcaktuara në nenin 61 të ligjit nr. 84/2016. Deklarimi i dyfishit të pasurisë është vetëm një ndër gjashtë (6) situatat, për të cilat mund të merret masa disiplinore, ajo në të cilën organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion përpos shkarkimit automatik. Kjo mënyrë leximi e interpretimi e organeve të rivlerësimit ka kaluar tashmë edhe testin e kontrollit të kryer nga GjEDNj-ja, duke nisur nga çështja kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, ndër të tjera, e cila ka lënë në fuqi vendimet e Kolegjit bazuar në këtë interpretim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky shkak ankimi është i pabazuar.

#### B.2.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurive të potencuara

##### I. Apartament banimi 3+1, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan

12. Subjekti ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, këtë pasuri të përfituar nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes të datës 31.07.2008, pjesën e saj takuese 50% dhe vlerën e apartamentit, e cila në rubrikën e përshkrimit të pasurisë deklarohet 5.552.157 lekë, ndërsa në rubrikën përbri deklarohet 4.700.000 lekë. Subjekti ka deklaruar likuidimin e çmimit prej 4.7 milionë lekësh me tre (3) këste, gjatë harkut kohor 2008 - 2013 si edhe burimet që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

12.1. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie, referuar shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim u bazua në konstatimin për deklaram të pasaktë të *burimit* të krijimit të pasurisë, *mënyrës* së pagesës dhe analizës financiare nga e cila subjekti rezultoi me *mungesë burimesh* të ligjshme për të likuiduar në tërësi çmimin 5.860.000 lekë të deklaruar në deklaratën *vetting*.

12.2. Në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga subjekti për t’i bërë pjesë të kësaj analize financiare, Komisioni ka përfshirë të ardhurat prej 19.250 lekësh, përfituar nga subjekti i rivlerësimit, nga puna e

---

<sup>18</sup> Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit: nr. 19/2019, paragrafi 22.15, që i përket subjektit Xh. Z.; nr. 1/2021, paragrafi 20-20.1, që i përket subjektit A. S.; nr. 16/2022, paragrafi 23, për subjektin M. V.; nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19, për subjektin A. Xh. etj.

saj si prokurore, gjatë periudhës 16.11.1990 – 01.03.1993, dhe të ardhurat prej 21.350 lekësh, nga puna e saj si hetuese, për periudhën 01.03.1993 – 15.09.1995.

12.3. Komisioni *nuk* përfshiu në mesin e burimeve të pretenduara të disponuara, të ardhurat në vlerën 68.250 lekë nga bashkëshorti i subjektit në vitet 1985 – 1993, nga puna e tij pranë ish Ndërmarrjes Bujqësore Elbasan, meqenëse subjekti nuk provoi me dokumentacion vlerën e tyre, por edhe për efektin e pakonsiderueshëm financiar e të ardhurave të realizuara përpara vitit 1992, referuar jurisprudencës së Kolegjit<sup>19</sup>. Po ashtu, Komisioni *nuk* përfshiu vlerën 4.200.000 lekë, nga shitja e një sipërfaqeje toke (2.100 m<sup>2</sup>) në vitin 2009 me argumentin se: (i) subjekti nuk provoi burimin e ligjshëm të tyre dhe pagimin e detyrimeve tatimore; (ii) këto ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, pasi janë përfituar në fund të vitit 2009, pasi ishin shlyer të gjitha detyrimet ndaj palës blerëse të apartamentit, dhe subjekti i ka deklaruar ato si *gjendje cash* në fund të vitit 2009. Komisioni *nuk* përfshiu as shumat prej 152.020 lekë në vit deri në vitin 2009, pretenduar si të përfituara nga shfrytëzimi i vreshtarisë të mbjellë në tokën me sipërfaqe 2.100 m<sup>2</sup>. Sipas Komisionit, përpos që vlerat e pretenduara nga eksperti vlerësues janë hipotetike, subjekti nuk provoi likuidimin e detyrimit tatimor mbi to. Përfitimi realisht i tyre nuk u vlerësua bindës edhe për faktin që në deklaratat periodike vjetore dhe në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar vetëm të ardhura nga dhënia *në përdorim* e kësaj toke në vitet 2006 – 2008 dhe jo të ardhura nga shfrytëzimi i saj. Së fundmi, të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm nuk u pranuan si burim dhe nuk u përfshinë si të tilla në analizën financiare të pasurisë objekt kontrolli, por ato u reflektuan si e ardhur në analizën e përgjithshme financiare, e konkretisht, për vitin 2008 është përfshirë vlera 2.211.755 lekë, e arkëtuar me bankë në vitin 2008, nga blerësi i apartamentit, ndërsa diferenca prej 432.500 lekësh, e paguar nga blerësi, është përfshirë në analizën e vitit 2009, vit në të cilin është bërë edhe kontrata e shitblerjes.

12.4. Trupi gjykues i Kolegjit, pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit në funksion të shkaqeve të ankimit të përmbledhura në pikën 6.6 e nën-pikat e tij më sipër, e që do të shtjellohen në vijim, vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Subjekti ka bërë deklarime të pasakta dhe kontradiktore në deklaratën *vetting* lidhur me vlerën e pasurisë, *periudhën* e shlyerjes së detyrimeve ndaj palës shitëse dhe burimin e krijimit të saj. Edhe në Kolegj *u konfirmua* balanca negative e burimeve financiare të ligjshme, për krijimin e pasurisë objekt analize, blerë kundrejt çmimit 5.552.157 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të *pasaktë*, të kryer në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe të *mungesës* së burimeve për krijimin e pasurisë objekt analize, në kuptim të germës “b”, të pikës 5 të të njëjtit nen. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit u mbështet në problematikat e konstatuara në lidhje me burimet e deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, shtjelluar në vijim.

12.5. Trupi gjykues fillimisht mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se nuk ndodhet në kushtet e deklarimit të pasaktë. Sipas ankimit, pasaktësitë në deklaratat periodike vjetore nuk cenojnë të provuarit bindshëm të burimit të krijimit me të ardhura të ligjshme të pasurive të deklaruar në deklarimin *vetting*. Subjekti shprehet se nuk duhet konsideruar si pasaktësi mosdeklarimi në deklaratën periodike për vitin 2008 i kontratës së sipërmarrjes dhe i vlerës së paguar apo edhe veprimeve juridike në deklaratat në vijim. Subjekti i rivlerësimit shprehet po ashtu se “ka menduar” se duhej t’i deklaronte këto veprime në

---

<sup>19</sup> Komisioni ka referuar vendimin nr. 14, datë 09.07.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

momentin e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Sa i përket mospërputhjes së vlerës së apartamentit në deklaratën *vetting*, subjekti pretendon se shoqëria ndërtuese i ka zbritur çmimit fillestar të blerjes së apartamentit, një shumë prej 360.000 lekësh, për punimet e kryera nga subjekti në vitin 2010.

12.6. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto pretendime janë të pambështetura në akte dhe në ligj. Subjekti ka bërë deklaratime të pasakta dhe kontradiktore në deklaratën *vetting* lidhur me vlerën e pasurisë, periudhën e shlyerjes së detyrimeve ndaj palës shitëse dhe burimin e krijimit të saj. Kontradiktat në deklaratimet e subjektit nuk kanë qenë sporadike, por të shpeshta, dhe të tilla që cenojnë besueshmërinë e subjektit në shpjegimet e saj dhe vështirëson analizën. Nga krahasimi i deklaratës *vetting* me deklaratat periodike vjetore, deklaratimet gjatë hetimit administrativ në Komision dhe faktet që rezultojnë nga aktet e administruara në dosje, trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni konstaton mungesë koherence, mospërputhje dhe kundërtënie në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, qoftë sa i përket çmimit të këtij apartamenti, mënyrës e periudhave të likuidimit të tij, ashtu edhe në lidhje me burimet e krijimit.

12.7. Fillimisht, për efekt të trajtimit shterues të çdo pretendimi në ankim, trupi gjykues i Kolegjit, nënvizon se ndryshe nga sa përpiqet subjekti ta paraqesë në ankim, konstatimet që e kanë çuar Komisionin në konkluzionin për deklarim të pasaktë, nuk i referohen gabimit në deklarimin e *sipërfaqes* së apartamentit në 11.8 m<sup>2</sup> kundrejt 116.5 m<sup>2</sup> sipas kontratës së shitjes kësaj pasurie. Referuar pikës nr. 1.39 të vendimit objekt shqyrtimi, ky pretendim rezultoi i pranuar nga Komisioni, i cili e ka konsideruar shifrën e deklaruar për sipërfaqen si gabim material/“lapsus” të subjektit gjatë plotësimit të deklaratës *vetting*.

12.8. Duke iu rikthyer pasaktësive/mospërputhjeve me relevancë në vendim, *së pari*, mospërputhje vërehen edhe brenda vetë formularit të deklaratës *vetting*, ku subjekti ka deklaruar për të njëjtën pasuri, dy vlera të ndryshme. Konkretisht, subjekti ka deklaruar vlerën e apartamentit rreth 5.5 milionë lekë -- që korrespondon me vlerën e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes dhe në atë të shitjes e mandatet e përshkruara në të -- dhe vlerën 4.7 milionë lekë, që korrespondon me tre këstet e deklaruara në deklaratën *vetting* (respektivisht në vitin 2008, likuiduar shuma prej 2.200.000 lekësh; në vitin 2010, shuma 2.000.000 lekë dhe në vitin 2013, është likuiduar shuma 500.000 lekë). Pretendimi i subjektit se mospërputhja në fjalë është pasojë e zbritjes së shpenzimeve (referuar më sipër) për punimet e kryera prej saj në vitin 2010, u vlerësua deklarative pasi nuk përputhet me aktet e kohës. Konkretisht, kontrata e sipërmarrjes e lidhur në datën 31.07.2008, parashikon se çmimi mund të ndryshojë vetëm nëse palët bien dakord *me shkrim* për të realizuar objektin sipas specifikimeve teknike që sjellin ndryshimin e kostos së ndërtimit. Subjekti nuk rezultoi të ketë depozituar asnjë akt në mbështetje të dakordësisë së pretenduar për ndryshimin, për ulje të çmimit fillestar prej 45.435 eurosh (ekuivalenti i 5.552.157 lekë).

12.9. E kundërta rezultoi nga kontrata e shitjes e datës 31.10.2017, e cila jo vetëm rikonfirmon si të pranuar nga palët, çmimin fillestar të shitjes të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, por nëpërmjet kësteve dhe likuidimit të tyre sipas mandateve, vërteton se pagesa *faktike* e likuiduar për apartamentin, konfirmon vlerën 5.550.000 lekë, sipas kontratës. Ky pretendim mund të ishte i besueshëm nëse subjekti do të kishte lënë gjurmë të shpenzimeve ose të ndryshimit të këtij aspekti të kontratës në akte të tjera të kohës, qoftë edhe në deklaratën periodike vjetore të atij viti ose në vijim,<sup>20</sup> për të provuar qoftë edhe

---

<sup>20</sup> Detyrimi për deklarim të shpenzimeve nga vlera 300.000 lekë e sipër u parashikua me ndryshimet që sjellë ligji nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049/2003.”

indirekt investimin e saj dhe personit të lidhur në këtë drejtim. Së fundmi, pretendimi për reduktimin e çmimit të shitjes me 360.000 lekë, nuk gjen mbështetje as në ankim, ku subjekti në pikën 5.2 rikonfirmon çmimin 5.5 milionë lekë, të likuiduar respektivisht në vitin 2008, në shumën 4.2 milionë lekë dhe në vitin 2009, në shumën 1.3 milionë lekë.

**12.10.** *Së dyti*, mospërputhje vërehen edhe ndërmjet deklaratës *vetting* dhe deklarimeve periodike vjetore. Konkretisht, ndërsa në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar tri këste të paguara në vitet 2008, 2010, dhe 2013, këto deklarime nuk gjejnë pasqyrim në deklaratat periodike të pasurisë të viteve 2008 dhe 2009, e as në ato të viteve në vazhdim, në të cilat subjekti nuk ka deklaruar detyrime të papaguara ndaj palës shitëse, për këtë pasuri. Po kështu, në deklaratën periodike për vitin 2008, nuk është deklaruar as blerja e kësaj pasurie apo ndonjë detaj që lidhet me të e pagesën e këstit të parë prej 2.200.000 lekësh, që sipas deklaratës *vetting* është pretenduar se është shpenzuar në vitin 2008. Deklarimi i kryer në deklaratën periodike për vitin 2010, për likuidimin e shumës 4.200.000 lekë sipërmarrësit për blerjen e kësaj pasurie, referuar aktmarrëveshjes së datës 06.03.2010, është i pari për këtë pasuri, ndërsa veprimet juridike me këtë person apo edhe pagesat e mëparshme nuk janë pasqyruar më herët. E njëjta gjë vlen edhe për këstin e fundit, në shumën 500.000 lekë, që sipas deklaratës *vetting* është kryer në vitin 2013, që nuk ka gjetur pasqyrim në deklaratën periodike për atë vit ose më pas.

**12.11.** Nga sa më sipër, rezulton se pretendimi i subjektit për mënyrën sesi ajo argumenton të ketë kuptuar detyrimin për deklarim, është tërësisht i pabazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049/2003, sipas të cilit, subjekti deklarues ka pasur detyrimin të deklarojë ndër të tjera, çdo pasuri të paluajtshme, të regjistruar ose jo në regjistrat publikë dhe të drejtat reale mbi to, e po ashtu edhe detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë. Ndërsa këto problematika në vetvete nuk e ngarkojnë subjektin me përgjegjësi në raport me ligjin nr. 84/2016, ato kontribuojnë në pasaktësitë e rezultuara në deklaratën *vetting*. E thënë ndryshe, në rrethanat konkrete, mosdeklarimet ndër vite për detyrimet e marra përsipër dhe shpenzimet e kryera për krijimin e kësaj pasurie, morën peshë në arritjen e konkluzionit për mungesën e besueshmërisë së deklarimeve të subjektit në vlerësimin e pasurisë, pasi e kundërta, pasqyrimi edhe i pjesshëm në deklaratat e kohës kur janë kryer veprimet, do të përbënte një provë të kohës që do të krijonte qartësi për kontrollin e pasurisë së deklaruar në deklaratën *vetting*. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, përveçse i pabazuar, nuk passjell asnjë ndryshim në zgjidhjen e çështjes, pasi është pa relevancë.

**12.12.** *Së treti*, vlera e pasurisë dhe kalendari i pagesave të deklaruara në deklaratën *vetting*, janë në kontradiktë me faktet që rezultojnë nga dokumentacioni i administruar. Konkretisht, referuar deklaratës *vetting*, pagesat për apartamentin janë likuiduar sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 31.07.2008, në kohën dhe vlerat si vijon: (i) në vitin 2008, shuma prej 2.200.000 lekësh, (ii) në vitin 2010, shuma 2.000.000 lekë dhe (iii) në vitin 2013, shuma 500.000 lekë -- në total 4.700.000 lekë. Sakaq, në kontratën e sipërmarrjes, palët kanë rënë dakord për modalitete të ndryshme: çmimi i shitjes prej 45.435 eurosh (i konvertuar në shumën 5.552.157 lekë), do të shlyhej me dy (2) këste. Vlera 2.200.000 lekë është likuiduar jashtë zyrës noteriale (pra përpara/ose në datën 31.07.2008 të kontratës), ndërsa kësti i dytë në shumën 3.352.147 lekë do të likuidohet brenda muajit *shtator* të vitit 2008.

**12.13.** Kjo nënkupton që deklarimi në deklaratën *vetting*, se likuidimi total i çmimit të blerjes ka përfunduar në vitin 2013, bie ndesh me vitin 2008 të specifikuar si moment kohor fundor nga palët në

kontratë. Në bazë dhe në vijim të kontratës së sipërmarrjes, palët kanë lidhur edhe kontratën e shitjes datë 31.10.2017, në të cilën rikonfirmohet çmimi i sipër-referuar përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, nga i cili shuma 4.200.000 lekë është likuiduar gjatë periudhës gusht – dhjetor 2008, shuma 1.300.000 lekë është paguar në vitin 2009, ndërsa shuma 50.000 lekë pa datë likuidimi<sup>21</sup>. Pra, ndërsa sipas deklaratës *vetting*, çmimi është 4.7 milionë lekë, nga i cili vlera 4.2 milionë lekë është likuiduar në vitet 2008 - 2010 (2.2 milionë lekë në vitin 2008 dhe 2 milionë në vitin 2010) ndërsa diferenca prej 500.000 lekësh është në vitin 2013, sipas dokumentacionit të administruar për këtë apartament, çmimi i rezultuar është 5.550.000 lekë, nga i cili shuma 4.2 milionë lekë është likuiduar gjatë periudhës gusht – dhjetor 2008; shuma 1.300.000 lekë është paguar në vitin 2009, ndërsa shuma 50.000 lekë pa datë likuidimi.

12.14. *Së fundmi*, deklarime kontradiktore vërehen edhe sa i përket burimeve të krijimit të kësaj pasurie. Në deklaratën *vetting*, ndër burimet e krijimit të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar shumën 2.632.500 lekë, të përfituar nga shitja e një tjetër apartamenti, dhe shumën 4.200.000 lekë, të përfituar nga shitja e një toke. Trupi gjykues vëren se, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka ndryshuar deklarin lidhur me burimet e krijimit, duke shprehur se për likuidimin e kësaj të parë në shumën 2.200.000 lekë në datën 31.07.2008, ka shërbyer pakësimi i gjendjes *cash* dhe të ardhurat e bashkëshortit nga vreshtaria. Ky deklarin është kontradiktor, pasi subjekti jo vetëm ka shtuar një burim të ri -- likuiditetet jashtë sistemit bankar -- në hetimin administrativ, por edhe bie ndesh me deklaratat periodike vjetore. Në këto të fundit, subjekti nuk ka deklaruar ndryshime të gjendjes *cash* -- në këtë rast pakësim -- me qëllim blerjen e kësaj pasurie apo shlyerje pagesash ndaj palës shitëse.

12.15. Këto aspekte, dhe të tjerë të arsyetuar në vijim, në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit, provojnë që subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarin të pasaktë, të kryer në kundërshtim me parashikimin e germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, konstatimi i Komisionit është i bazuar.

13. Trupi gjykues i Kolegjit vijoi verifikimin e grupit të dytë të pretendimeve të subjektit në drejtim të balancës negative të konkluduar nga Komisioni për këtë pasuri. Përkundër konstatimit të Komisionit për pamundësi të përbalimit të gjithë pagesës për apartamentin, subjekti pretendon se ka pasur aftësi pague për blerjen e kësaj pasurie, përkatësisht në shumën 4.200.000 lekë, të likuiduar në vitin 2008 -- me të ardhurat e realizuara nga puna e subjektit dhe bashkëshortit, të ardhurat nga shitja e vreshtit, dhe në shumën 1.300.000 lekë të likuiduar në vitin 2009 -- me të ardhurat e realizuara nga puna e subjektit dhe bashkëshortit dhe të ardhurat e realizuara nga shitja e një apartamenti tjetër në Elbasan (me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>). Në funksion të analizës financiare për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ngre shkaqe ankimi, qoftë në lidhje me të ardhurat e pretenduara si burim për krijimin e apartamentit objekt analize, ashtu edhe për shpenzimet.

---

<sup>21</sup>Referuar kontratës së shitblerjes, datë 31.10.2017, çmimi i shitjes (45.435 euro), është likuiduar pa vërejtje sipas këtij kalendari pagesash: (a) në vitin 2008, është paguar vlera 2.200.000 lekë (likuiduar në datën 01.08.2008, sipas mandatit nr. {\*\*\*}), vlera 600.000 lekë (likuiduar në datën 27.11.2008, sipas mandatit {\*\*\*}), vlera 400.000 lekë (likuiduar në datën 02.12.2008, sipas mandatit {\*\*\*}) dhe vlera 1.000.000 lekë (likuiduar më datë 18.12.2008, sipas mandatit {\*\*\*}); (b) në vitin 2009, është paguar vlera 1.300.000 lekë (likuiduar më datë 25.05.2009, sipas mandatit nr. {\*\*\*}); (c) dhe vlera 50.000 lekë (sipas mandatit {\*\*\*}, pa datë likuidimi).

13.1. Në mënyrë të detajuar, zërat e analizës dhe arsyetimi i parashtruar nga subjekti paraqiten më sipër në paragrafin 6.6. Pa përsëritur sa më sipër, për lehtësi reference, në mënyrë të përmbledhur argumentet e subjektit fokusohen në pretendimin se:

(i) Ka provuar përfitimin e shumës 4.200.000 lekë nga para-shitja e vreshtit, të cilin blerësi e gëzon që nga dhjetori 2009, pavarësisht mosformalizimit të në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për shkak të problemeve administrative të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan. Detyrimet tatimore do të shlyhen në momentin e shitblerjes, sapo të bëhet e mundur nxjerrja e këtyre dokumenteve të pronësisë.

(ii) Është i gabuar konkluzioni për mungesë burimesh nga shitja e apartamentit të blerë në vitin 1997, që vjen si derivat i balancës negative të burimeve të ligjshme për blerjen e tij. Shuma prej 2.200.000 lekësh e arkëtuar në datën 14.05.2008 në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nga blerësi, përfaqëson parapagimin e vlerës së përcaktuar në kontratën e datës 05.05.2009. Kjo shumë e tërhequr në datën 01.08.2008, nuk duhet konsideruar si shpenzim në analizën financiare të vitit 2008. Komisioni duhet të përfshijë në analizë të ardhura të saj dhe bashkëshortit nga pagat e viteve 1985 e në vijim, dhe të ardhurat neto në shumën 1.368.180 lekë nga ekonomia bujqësore familjare mbi pasurinë “vresht”, gjatë viteve 1993 – 2002 dhe shumën 152.020 lekë/vit pas vitit 2002.

(iii) Gjendja *cash* për të gjithë periudhën e deklarimit 2003 – 2017, është përlllogaritur sipas një metodologjie të gabuar, duke u bazuar në të dhënat e deklaruara prej saj, me hamendje.

13.2. Pasi analizoi aktet në fashikull dhe pretendimet e kërkimet e mësipërme, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit është i bazuar. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit edhe në Kolegj, pavarësisht prej disa korrektimeve, u konfirmua mungesa e burimeve financiare të ligjshme të subjektit, për krijimin e pasurisë objekt ankimi. Për rrjedhojë, për këtë pasuri, përpos deklarimit të pasaktë, si më sipër analizuar, ajo gjendet njëkohësisht edhe në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e pasurisë objekt analize, në kuptim të germës “b”, të pikës 5, të të njëjtit nen. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit u mbështet në problematikat e konstatuara në lidhje me burimet e deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, shtjelluar në vijim.

13.3. Së pari, për sa i përket shumës prej 4.2 milionë lekësh, që deklarohet e fituar nga shitja e vreshtit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i drejtë konstatimi i Komisionit për të mos e përfshirë këtë vlerë në mesin e burimeve të ligjshme, në kushtet që ky transaksion ka gjeneruar të ardhura *pasi* subjekti kishte shlyer një pjesë të konsiderueshme të çmimit të apartamentit. Nga ana tjetër, është e pabazuar mospërfshirja nga Komisioni e kësaj vlere në mesin e të ardhurave të disponuara në vitin 2009. Ndryshe nga çfarë ka konkluduar Komisioni, shitja e kësaj pasurie është kryer në formën e kërkuar nga ligji. Referuar legjislacionit në fuqi në kohën kur është lidhur akt-marrëveshja, e konkretisht nenit 54 të ligjit nr. 7829, datë 01.06.1994, “Për noterinë”,<sup>22</sup> sipas formulimit që ky nen ka pasur në dhjetor 2009, trupi gjykues i Kolegjit vëren se shitja e tokës nuk mund të bëhet me akt noterial, pasi i mungonte akti i regjistrimit/njohjes së pronësisë nga organi kompetent apo një vendim gjyqësor për vërtetim pronësie.

---

<sup>22</sup>Ligji nr. 7829/1994 (aktualisht i shfuqizuar) në nenin 54 përcaktonte: “[...] Akti noterial për tjetërsimin ose njohjen e pronësisë mbi sende të paluajtshme, ose të një të drejte reale mbi to, kryhet nga noteri, pasi të ketë verifikuar pronësinë e palës mbi sendin e paluajtshëm. Për këtë qëllim ajo i paraqet noterit dokumentet e pronësisë të lëshuara nga organi kompetent dhe, kur sendi nuk figuron i regjistruar, një vendim gjyqësor për vërtetim pronësie. Noteri duhet të shënojë në akt verifikimin e bërë. [...]”

Në kushtet që kjo pasuri nuk ishte e regjistruar dhe i vetmi dokumentacion pronësie ishte akti i marrjes së tokës në pronësi në bazë të ligjit “Për tokën”<sup>23</sup>, shitja e pasurisë me aktmarrëveshje pranë një avokati nuk e bën të pavlefshme marrëdhënien juridike, në kuptim të kalimit të së drejtës së pronësisë dhe përfitimit të çmimit. Ky i fundit në aktmarrëveshjen e marrë në analizë është deklaruar se është i pakthyeshëm.

13.4. Po ashtu, nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie jo vetëm në deklaratën *vetting*, por edhe në DIPP-në 2009, shoqëruar edhe me akte të kohës<sup>24</sup> të rikonfirmuara<sup>25</sup> edhe në vitin 2022, ndonëse për efekt të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se në kuptim të pikës 5, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, këto deklarata mund të konsiderohen si akte me vlerë provuese në drejtim të besueshmërisë së përfitimit të shumës 4.200.000 lekë, nga shitja e kësaj toke në bazë të aktmarrëveshjes datë 29.12.2009. Në të njëjtën linjë, ndonëse për këto të ardhura subjekti nuk ka shlyer detyrimet tatimore, në kuptim të detyrimit të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 19, të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, është i bazuar pretendimi i subjektit se detyrimet tatimore për të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie lindin në momentin që kjo pasuri do të regjistrohet në ASHK. Në këtë vlerësim trupi gjykues mban në konsideratë aktet ligjore të kohës e konkretisht, nenin 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, sipas formulimit që ky nen ka pasur në dhjetor të vitit 2009,<sup>26</sup> Udhëzimin nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pasurisë së paluajtshme”, i ndryshuar, si edhe qëndrimin e Kolegjit për çështje të ngjashme<sup>27</sup>. Bazuar në këto akte, mund të prezumohet se detyrimi për të paguar detyrimin tatimor do të lindë në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes dhe regjistrimit të pasurisë në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

13.5. Analiza e mësipërme është bërë në funksion të trajtimit shterues të çdo pretendimi të ngritur në ankim, pasi ajo nuk ka asnjë efekt financiar në drejtim të pretendimit kryesor që është ai i konsiderimit të këtyre të ardhurave si burim i ligjshëm për pasurinë objekt vlerësimi. Trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni, vlerëson se këto të ardhura, edhe nëse kanë ekzistuar vërtet, nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, jo vetëm sepse ato deklarohen të jenë krijuar në dhjetor 2009, shtatë (7) muaj pasi ishte likuiduar thuajse e gjithë vlera e pasurisë, qoftë sipas kontratës së shitjes apo asaj të sipërmarrjes, por edhe për faktin që të ardhurat e pretenduara nga shitja e vreshtit janë deklaruar në fund të vitit 2009 si *gjendje cash në banesë*. Ky deklaram i kohës i subjektit, nënkupton se këto të ardhura nuk janë përdorur për të shlyer këstet e apartamentit.

13.6. Ndërsa për efekt të analizës financiare, trupi gjykues i Kolegjit, ndryshe nga Komisioni, vlerësoi se shuma 4.2 milionë duhet përfshirë si e ardhur e ligjshme për vitin 2009, në konsideratë të gjurmëve

---

<sup>23</sup> Referuar konfirmimit nr. {\*\*\*} prot., datë 16.02.2022 të ASHK Elbasan, depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr.3, sipas të cilit, zona kadastrale nr. {\*\*\*} nuk është azhornuar në sistemin e ri të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe se ASHK, Drejtoria Vendore Elbasan disponon vetëm aktet e marrjes së tokës në pronësi, ndër të cilat edhe AMTP nr. {\*\*\*}, në emër të bashkëshortit të subjektit për tokën e ndodhur në fshatin {\*\*\*}, Elbasan.

<sup>24</sup> Aktmarrëveshje datë 29.12.2009, lidhur ndërmjet shitësit I. M. dhe blerësit F. H.

<sup>25</sup> Me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} datë 26.04.2022, depozituar nga subjekti në seancë dëgjimore.

<sup>26</sup> Ligji nr. 9716, datë 16.4.2007, riformuloi nenin 11 në këtë mënyrë: “[1.] Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, tokë e ndërtesa, tatóhet me 10 për qind të fitimeve kapitale të realizuara. [...]. 2. Tatimi paguhet nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. 3. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda 10 ditëve, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni. [...]”

<sup>27</sup> Vendimi nr. 29, datë 21.07.2022, paragrafët 57 e 58, që i përket subjektit të rivlerësimit E. D.

në deklaratën periodike të atij viti, në aktet e kohës, sipas vlerësimit të shtjelluar më sipër për detyrimin tatimor të të ardhurave nga shitja, kushtëzuar nga regjistrimi i pronës. Nga ana tjetër, sikurse arsyetuar edhe në vijim, edhe në këtë variant, analiza financiare e vitit 2009 do të rezultonte sërish me balancë negative.

13.7. Shkaku tjetër tek i cili fokusohet ankimi, janë të ardhurat e fituara nga shitja në datën 05.05.2009 e një apartamenti në tjetër në Elbasan, që subjekti e bashkëshorti kanë blerë në vitin 1997. Subjekti kërkon që shuma prej 2.632.500 lekësh, nga shitja e kësaj pasurie, të përfshihet në mesin e burimeve të disponuara dhe përdorura për apartamentin objekt ankimi. Meqenëse nga hetimi administrativ ka rezultuar pagesa e një shume prej 2.200.000 lekësh në datën 14.05.2008 në llogarinë e bashkëshortit të subjektit nga blerësi i këtij apartamenti, subjekti kërkon që ai transaksion të konsiderohet si parapagim i vlerës së përcaktuar në kontratën e datës 05.05.2009. Kjo shumë, e tërhequr nga bashkëshorti i saj nga banka në datën 01.08.2008, sipas subjektit duhet konsideruar në analizë financiare të vitit 2008 si e ardhur, dhe jo si shpenzim, sikurse e ka trajtuar Komisioni.

13.8. Nga aktet në fashikull rezulton se Komisioni fillimisht ka konstatuar se nga analiza financiare për periudhën 1985 – 1997, subjekti ka rezultuar me një pamjaftueshmëri financiare për blerjen e apartamentit në fjalë kundrejt çmimit 1.150.000 lekë, të përcaktuar në kontratën e shitblerjes datë 12.02.1997, blerjen e pasurive të tjera dhe mbulimin e shpenzimeve të periudhës. Ndërsa, sa i përket momentit kohor të përfitimit të shumës 2.632.500 lekë nga shitja e të njëjtit apartament, referuar arsyetimit në pikën nr. 1.28 të vendimit, rezulton se në analizën financiare paraprake, shuma 2.200.000 lekë e arkëtuar në llogarinë bankare të bashkëshortit të subjektit, nuk është konsideruar nga Komisioni si e ardhur e arkëtuar në vitin 2008, por është njohur si e ardhur për vitin 2009, referuar kontratës së shitblerjes datë 05.05.2009, të lidhur ndërmjet palëve. Pas kalimit të barrës së provës, referuar arsyetimit në paragrafët 1.43 - 1.44 të vendimit, rezulton se Komisioni nuk ka bërë më vlerësim në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>. Komisioni ka bërë vetëm një risistemim/rishpërndarje të të ardhurave, duke pranuar pretendimin e subjektit se shuma 2.2 milionë lekë e arkëtuar në bankë në vitin 2008 është parapagim i çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratën e shitblerjes datë 05.05.2009. Për rrjedhojë, Komisioni ka vlerësuar të përfshijë tek të ardhurat e ligjshme të vitit 2008, shumën 2.200.000 lekë të arkëtuar në vitin 2008 në llogarinë bankare të bashkëshortit, ndërsa diferencën e çmimit prej 432.500 lekësh e ka konsideruar si të ardhur në vitin 2009 sipas kontratës së shitjes me blerësin. Nga ana tjetër, Komisioni e ka konsideruar shumën e tërhequr nga bashkëshorti i subjektit në gusht 2008 si shpenzim dhe jo si të ardhur të vitit.

13.9. Nga sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit çmon fillimisht të nënvizojë disa aspekte në analizën e Komisionit lidhur me këtë pasuri. Konkretisht, ndërsa nga njëra anë rezulton një qasje tejet favorizuese në kushtet që Komisioni ka konsideruar të ligjshme të ardhurat nga shitja e apartamentit të blerë në vitin 1997, ndonëse subjekti ka rezultuar me mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e tij, nga ana tjetër, shumën prej 2.200.000 lekësh nga shitja, që bashkëshorti i subjektit e ka tërhequr në gusht 2008, Komisioni ka vendosur ta konsiderojë si shpenzim i kryer atë vit. Mungesa e burimeve financiare të ligjshme, për blerjen e kësaj pasurie<sup>28</sup> kundrejt çmimit 1.150.000 lekë të përcaktuar në kontratën e

---

<sup>28</sup> Referuar deklaratimit, apartamenti 2+1 ishte blerë me të ardhurat nga shitja e një apartamenti 1+1 në vlerën 150.000 lekë, me të ardhurat në vlerën 400.000 lekë nga shitja në datën 03.06.1997 e dy dhomave të një apartamenti të privatizuar, si dhe me kursimet familjare, pa specifikuar vlerë.

shitblerjes të datës 12.02.1997, u konfirmua edhe në Kolegj, me të njëjtin rezultat negativ prej (-) 924.066 lekësh, të konstatuar edhe në Komision. Në këtë analizë, sikurse edhe Komisioni,<sup>29</sup> trupi gjykues i Kolegjit përfshiu të ardhurat e subjektit të rivlerësimit nga pagat për periudhën 1993 – 1995, si hetuese në Prokurorinë e Rrethit Elbasan. Nga ana tjetër, të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi në ish-NB për vitet 1985 – 1993, nuk provohen, përpos që qëndron konstatimi i Komisionit për t’i vlerësuar të pakonsiderueshme dhe pa efekt financiar të ardhurat para vitit 1992, referuar sa është arsyetuar gjerësisht, në jurisprudencën e Kolegjit.

13.10. Në vijim të arsytimit të mësipërm, duke mbajtur në konsideratë konkluzionin e Komisionit të konfirmuar edhe në Kolegj, për pamundësinë e subjektit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 65 m<sup>2</sup>, do të duhej që edhe e ardhura e përfitur nga shitja e tij, në vlerën 2.632.500 lekë, të mos konsiderohej si e ardhur e ligjshme në analizën financiare 2003 – 2016 (në vitet 2008 e 2009). Këtë aspekt me rëndësi për analizën financiare, trupi gjykues e sjell si rikonfirmim të qëndrimit të përsëritur e konsoliduar e në jurisprudencën e Kolegjit<sup>30</sup>, se mungesa e burimeve financiare në krijimin e një pasurie, defekton legjitimitetin e të ardhurave që mund të krijohen nga tjetërsimi i saj në vijim. Po kështu, trupi gjykues çmon të arsyeshme të risjellë në vëmendje edhe faktin se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti, së bashku me ato nga shitja e vreshtit, kanë shërbyer si burim për krijimin e kursimeve në shumën 5.5 milionë lekë, e cila sipas deklaratimit të subjektit në deklaratën periodike për vitin 2009, deklarohej se disponohej “gjendje në shtëpi” në fund të vitit 2009. Ky fakt, i vetëm, përjashton mundësinë e përdorimit të këtyre fondeve/të ardhurave si burim për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi.

13.11. Në konsideratë të garancive procedurale për mospërkeqësimin e situatës së subjektit si rrjedhojë e ankimit, trupi gjykues i Kolegjit është i detyruar ta përfshijë në analizën e tij në mesin e të ardhurave të ligjshme, shumën 2.632.500 lekë të arkëtuar në vitet 2008 dhe 2009, në të njëjtën linjë me Komisionin. Ndërkaq, trupi gjykues i Kolegjit e vlerëson të arsyeshëm pretendimin e subjektit se shuma e tërhequr nga llogaria e bashkëshortit të saj në datën 01.08.2008, nuk duhet konsideruar në analizë financiare si shpenzim i kryer në këtë vit. Konsiderimi i këtij veprimi si shpenzim, do ta rëndonte padrejtësisht situatën financiare të subjektit në kushtet që referuar akteve të administruara në dosje, nuk rezulton ndonjë shpenzim tjetër, përveç atyre të pasqyruara nga Komisioni.

13.12. Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka llogaritur në analizë financiare shumën 1.368.180 lekë, të përfitur nga ekonomia bujqësore familjare nëpërmjet shfrytëzimit të vreshtit gjatë viteve 1993 – 2002, dhe as shumën 152.020 lekë/vit të realizuar nga e njëjta veprimtari në vitet 2002 deri në vitin 2009. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti nuk ka arritur t’i provojë këto të ardhura, qoftë në planin ekzistencial dhe as në atë të ligjshmërisë së tyre. Konkretisht, vërehet se vlera e të ardhurave të pretenduara nga veprimtaria bujqësore nuk i referohet akteve të kohës (për shembull licenca, fatura, mandate etj.), që mund të provonin ushtrimin realisht të veprimtarisë bujqësore dhe përfitimin e të ardhurave nga kjo veprimtari. Subjekti i referohet vetëm një akti ekspertimi bujqësor të përpiluar gjatë procesit të rivlerësimit, i cili nuk mund të ketë vlerë provuese për sa pretendohet në

---

<sup>29</sup> Referuar pikave 1.41 dhe 1.42 të vendimit objekt ankimi, rezulton se pretendimi për pagat e subjektit, është pranuar që në Komision.

<sup>30</sup> Vendimi nr. 43, datë 23.10.2023, pika 13.6 që i përket subjektit A. K., vendimi nr. 54, datë 19.12.2023, pika 20.5 dhe nënpikat, që i përket subjekti K. H.

këtë proces. Vlerat e pasqyruara në këtë akt ekspertimi, mbeten hipotetike dhe nuk pasqyrojnë situatën faktike të kohës, për sa kohë janë përpiluar duke u bazuar mbi të dhëna statistikore dhe manualët në këtë fushë.

13.13. Mbi të gjitha, ekzistenca e këtyre të ardhurave nuk gjen pasqyrim as në deklaratën për herë të parë të pasurisë të vitit 2003, dhe as në deklaratat periodike të viteve përkatëse, DIPP-të e viteve 2003 dhe 2004, në të cilat subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga shfrytëzimi i kësaj sipërfaqe toke në vitet 1993 – 2004, ndërsa në deklaratat për vitet 2005 deri 2008, si edhe në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti ka pretenduar të ardhura vetëm nga dhënia në *përdorim* e kësaj toke në vitet 2005 – 2008, jo nga shfrytëzimi i saj. Në kushtet që subjekti nuk ka provuar këto të ardhura në aspektin ekzistencial, përjashtohet mundësia e përmbushjes së kriterit të ligjshmërisë për këtë zë të ardhurash të pretenduara. Për sa më sipër, Kolegji konfirmon vlerësimin e Komisionit për të mos i përfshirë këto të ardhura në analizë financiare.

*II. Pretendime në lidhje me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>”, ndodhur në qytetin e Pogradecit, blerë kundrejt vlerës 2.200.000 lekë*

14. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* një apartament me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup> në qytetin e Pogradecit, të blerë në bazë të aktmarrëveshjes të datës 17.08.2010 me pronarin e truallit (z. A. B.) dhe që nuk disponon certifikatë pronësie. Sipas deklaratës, vlera e pasurisë është 2.200.000 lekë dhe pjesa takuese e subjektit në këtë pasuri është 50%. Si burime për blerjen e kësaj pasurie janë deklaruar: (i) të ardhurat prej 1.152.000 lekësh, përfituar nga shitja e një garsoniereje<sup>31</sup> gjithashtu të ndodhur në Pogradec; (ii) të ardhura nga puna e bashkëshortit si avokat, kursimet e akumuluar ndër vite nga pagat e subjektit, dhe të bashkëshortit nga avokatia; (iii) të ardhurat nga kthimi i një pjese të detyrimit nga një individ (znj. F. Zh.); (iv) të ardhurat e përfituara nga shitja e një automjeti (i markës “Fiat Croma”).

14.1. Komisioni konkludoi se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vlerën 2.200.000 lekë, duke u gjendur në kushtet e përcaktuara në gerrat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Në vlerësimin e Komisionit, (i) subjekti nuk arriti të provonte me dokumentacion të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, pretenduar si burim për blerjen e garsonieres në vitin 2004, e cila në vijim ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit objekt analize; (ii) pas kalimit të barrës së provës për pasurinë “garsoniere”, subjekti shtoi si burim edhe një shumë 250.000 lekë nga shitja e automjetit “Fiat Croma”; (iii) subjekti dhe bashkëshorti rezultuan me burime të pamjaftueshme për likuidimin e shumës 2.000.000 lekë në vitin 2010. Ndër të ardhurat e pretenduara, Komisioni bëri pjesë të kësaj analize financiare edhe të ardhurat nga pagat e subjektit dhe nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat.

14.2. Ndërsa pretendimet e subjektit për këtë konkluzion janë referuar më sipër, në mënyrë të përmbledhur ato fokusohen kryesisht në aftësinë paguese të shumës 2.000.000 lekë që subjekti potencon se e kishte në vitin 2010, nga përdorimi i gjendjes monetare të fillimvitit 2010 dhe të ardhurat e realizuara nga shitja në vitin 2010 e garsonieres me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup> ndodhur po në Pogradec, e po ashtu edhe për shumën 200.000 lekë, të paguar në vitin 2011 me likuiditetet monetare tepricë të fillimvitit 2011. Në

<sup>31</sup> Sipas deklaratës *vetting*, kjo garsoniere është deklaruar në vitin 2004 dhe është paguar me këste deri në vitin 2006, kur është bërë edhe kontrata e shitblerjes me shitësin në vlerën 700.000 lekë. Ndërsa sipas ankimit, garsonierja është shlyer e gjitha në vitin 2004.

funksion të burimeve të pretenduara për krijimin e apartamentit në fjalë, subjekti potencon se ka pasur aftësi paguese për blerjen, në vitin 2004, të pasurisë “garsoniere”, kundrejt çmimit 700.000 lekë me të ardhurat e realizuara në vitin 2006 nga shitja e automjetit “Fiat Croma” dhe të ardhurat e bashkëshortit nga puna në emigracion në vitin 1996. Për sa më sipër, të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj garsoniereje që gjeneroi gjendje monetare në fillim vitin 2010, duhet të konsiderohen si burim i ligjshëm dhe duhet të përfshihen në analizën financiare të apartamentit objekt kontrolli.

14.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit për këtë pasuri, vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, janë në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të mundësuar pagesën e këstit të parë prej 2.000.000 lekësh, në vitin 2010. Subjekti gjendet në kushtet e deklaramit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, referuar përcaktimit të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 i ligjit nr. 84/2016. Në këtë vlerësim trupi gjykues mbajti në konsideratë qoftë kontradiktat e theksuara në deklaramit e subjektit për mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, që krijojnë probleme për besueshmërinë e pretendimeve të saj, sikurse edhe pamjaftueshmërinë financiare të burimeve të ligjshme të disponuara prej saj dhe personit të lidhur në funksion të krijimit të kësaj pasurie. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i bazuar. Ky vlerësim i Kolegjit u bazua në konkluzionet e mbërritura nga shqyrtimi i shkaqeve të ankimit të përmbledhura më lart, në pikën 6.7 të këtij vendimi, sipas arsytimit që do të shtjellohet në vijim.

14.4. *Së pari*, trupi gjykues sjell në vëmendje se, gjatë analizimit të kësaj pasurie në Kolegj, u konstatuan një sërë mospërputhjesh në deklaramit e subjektit, qoftë sa i përket apartamentit objekt kontrolli, ashtu edhe burimeve të pretenduara për krijimin e tij. Këto problematika të evidentuara në Komision e të konfirmuara edhe në Kolegj, vlerësohen të tilla që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklaramit të pasaktë, të kryer në kundërshtim me parashikimet e shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, çmimi i blerjes së pasurisë, 2.2 milionë lekë, i deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nuk përputhet me deklaramin e kryer në deklaratën për vitin 2010 në të cilën subjekti ka deklaruar vetëm likuidimin e shumës 2.000.000 lekë, por jo detyrim të mbetur të pashlyer ndaj palës shitëse në vlerën 200.000 lekë. Burimet e krijimit të apartamentit rezultojnë të jenë deklaruar vetëm në deklaratën *vetting* dhe jo në deklaratën për vitin 2010, pavarësisht nga detyrimi për të specifikuar këtë detaj.<sup>32</sup>

14.5. Edhe për garsonieren, e cila pas shitjes ka gjeneruar të ardhura që kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit objekt analize, konstatohen mospërputhje ndërmjet deklaratës *vetting* me ato periodike, midis deklaramiteve periodike si edhe ndërmjet tyre dhe dokumentacionit. Konkretisht, ndërsa

---

<sup>32</sup> Ky detyrim përcaktohet qartë në modelin e Deklaratës së Interesave Privatë Periodikë/Vjetorë, të miratuar përmes urdhrin nr. 77, datë 26.12.2008, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 36, datë 10.10.2006, të Inspektorit të Përgjithshëm “Për Miratimin e Llojeve të Deklaratës së Interesave Privatë”. Gjatë plotësimit të DIPP-së të vitit 2010 sipas formularit të miratuar me aktet e mësipërme, subjekti ka pasur mundësi për t’u njohur me këtë detyrim ligjor të specifikuar edhe në DIPP 2010, e konkretisht në rubrikën “Informacion në ndihmën tuaj”, në të cilën shprehet ekzaktësisht: “Në deklaramin periodik/vjetor, duhet të pasqyrohen vetëm ndryshimet (shtesat e pakësimet) e pasurive të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi to, pasurive të luajtshme, detyrimeve financiare, interesave të tjera dhe burimin e krijimit të tyre, për periudhën nga deklarimi i mëparshëm deri në 31 dhjetor të vitit të deklarimit”. Mosdeklarimi i burimit të krijimit nuk mund të konsiderohet si mungesë dijenie, nisur nga qasja e subjektit në deklaramit e mëparshme, në të cilat ka deklaruar burimin e krijimit për disa pasuri. Përmendim këtu deklaramin në deklaratën për vitin 2007, ku subjekti ka deklaruar apartamentin garsoniere të ndodhur në Pogradec si edhe burimin e krijimit të saj.

në deklaratat periodike për vitet 2004 dhe 2005 kjo garsoniere deklarohet me sipërfaqe 46 m<sup>2</sup> e vlerë 120.000 lekë, pa burime krijimi, në deklaratën për vitin 2007 deklarohet një garsoniere me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>, vlerë 1.200.000 lekë, e krijuar me të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni (në Itali), që kapin vlerën 15.000 euro. Kontradikta evidentohen edhe në lidhje me çmimin e shitjes së garsonieres. Sipas deklaratës *vetting*, çmimi është 1.152.000 lekë, ndërsa sipas deklaratës për vitin 2010, është 700.000 lekë. Po kështu, ndërsa sipas deklaratës *vetting*, garsonierja -- me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup> -- ishte blerë kundrejt shumës 700.000 lekë dhe paguar me këste *deri* në vitin 2006 (viti i kontratës së shitblerjes), në deklaratën periodike për vitin 2006 nuk gjendet asnjë pasqyrim i kontratës datë 20.12.2006 nëpërmjet të cilës është blerë garsonierja, dhe as të shpenzimit për të shlyer pagesën e shumës 700.000 lekë për blerjen e saj. Së fundmi, sipas ankimit, çmimi i blerjes prej 700.000 lekësh, është paguar në vitin 2004.

14.6. Përpos kontradiktave të mësipërme të deklarimeve të subjektit në kohë të ndryshme, trupi gjykues i Kolegjit vëren problematika edhe në aktet e depozituara në Komision. Konkretisht, me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka depozituar kontratën e shitblerjes<sup>33</sup> datë 20.12.2006, nëpërmjet të cilës ajo ka blerë apartamentin me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>, në Pogradec, në shumën 700.000 lekë, ndërsa me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, për të njëjtën pasuri subjekti ka depozituar një tjetër kontratë shitblerjeje<sup>34</sup> të hartuar në datën 20.03.2007, tre muaj pas kontratës së parë, pranë të njëjtit noter. Në vlerësimin e trupit gjykues të Kolegjit është e pakuptueshme nevoja për hartimin e dy kontratave me rekuizita dhe data të ndryshme, për të njëjtin objekt, dhe me të njëjtat detyrime për palët. Sipërfaqet dhe vlerat e ndryshme të blerjes së garsonieres në fjalë, në disa deklarata periodike vjetore deklarohet 46 m<sup>2</sup> dhe 120.000 lekë në mars 2005 dhe mars 2006 (në deklaratat periodike për vitet 2004 dhe 2005 përkatësisht) dhe më pas, në mars 2008, deklarohet me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup> dhe vlerë 1.200.000 lekë (në deklaratën për vitin 2007). Në deklaratën *vetting*, deklarohet e njëjta sipërfaqe (25 m<sup>2</sup>), por në vlerën 700.000 lekë. Të gjitha këto deklarime janë në kontradiktë jo vetëm mes tyre, por edhe me dy kontratat e shitblerjes të cilat përcaktojnë si çmim blerjeje vlerën 700.000 lekë, e me të drejtë janë konstatuar nga Komisioni si veprime fiktive të kryera nga subjekti për caktimin e vlerës në kontratën e blerjes së pasurisë. Trupi gjykues vëren se pasi subjektit i ka kaluar barra e provës, nuk rezulton që Komisioni të ketë bërë vlerësim për këtë aspekt duke e lënë pa përgjigje.

14.7. *Së dyti*, pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur/bashkëshorti, janë në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme, për të mundësuar pagesën e këstit të parë, prej 2.000.000 lekësh, në vitin 2010, për blerjen e pasurisë objekt analize. Për rrjedhojë, subjekti gjendet edhe në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016, përpos ndodhjes në kushtet e deklarimit të pasaktë sipas arsyetimit në paragrafët e mësipërm.

14.8. Në përgjigje të pretendimeve të subjektit që kanë në fokus argumentim të mundësisë financiare të subjektit për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues i Kolegjit, sjell sërish në vëmendje problematikën e kundërthënieve të subjektit e cila është prezente edhe në burimet e pretenduara për krijimin e apartamentit në Pogradec. Kështu, në deklaratën *vetting*, subjekti specifikon katër burime e konkretisht: (i) shumën 1.152.000 lekë nga shitja e garsonieres; (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga veprimtaria e

<sup>33</sup> Kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.12.2006, pranë noter Th. B.

<sup>34</sup> Kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.03.2007, pranë të njëjtit noter, Th. B.

avokatisë dhe kursimet e akumuluar ndë vite nga paga e subjektit dhe puna e bashkëshortit si avokat; (iii) të ardhurat nga kthimi i një pjese të detyrimit nga një huamarrëse (znj. F. Zh.); (iv) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “Fiat Croma”. Ndërsa në pyetësonin nr. 2, subjekti shpjegon se çmimi i blerjes prej 2.2 milionë lekësh, është likuiduar me dy këste e konkretisht: (i) likuidimi i kështit të parë prej 2 milionë lekësh në datën 17.08.2010, është mundësuar nga shuma 1.152.000 lekë nga shitja e garsonieres dhe nga pakësimi i gjendjes *cash* të deklaruar në fund të vitit 2009; (ii) kësti i dytë prej 200.000 lekësh është likuiduar në datën 31.03.2011 me pakësimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2010 dhe me të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2010 deri në momentin e pagesës. Me fjalë të tjera, në këtë pyetëson, subjekti ka shtuar si burim edhe pakësimin e gjendjes *cash* në vitin 2009, duke e ndryshuar burimin e deklaruar në deklaratën *vetting*.

14.9. Edhe duke abstraguar nga problematikat e mësipërme që tregojnë mungesë besueshmërie në deklaratimet e subjektit, në lidhje me themelin e pretendimit për ta njohur gjendjen e likuiditeteve *cash*, si burim të ligjshëm për krijimin e pasurisë objekt analize, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pakësimi i gjendjes *cash* në vitin 2009, i pretenduar rishtazi në pyetësonin nr. 2, nuk gjen pasqyrim në deklaratën periodike të kohës, atë për fundvitin 2009. Sipas deklaratimit të subjektit në mars 2010, ajo ka disponuar *gjendje* në shtëpi në fund të atij viti, shumën 5.5 milionë lekë. Për më tepër, edhe sikur hipotetakisht të pranohej pretendimi për pakësimin e gjendjes *cash* të fundvitit 2009, ky pakësim nuk mund të shërbente si burim për apartamentin objekt shqyrtimi, pasi e njëjta sasi likuiditeteve është pretenduar si burim edhe për apartamentin e analizuar më sipër.

14.10. Duke iu rikthyer kontrollit të të ardhurave në shumën 1.152.000 lekë, përfituar nga shitja e garsonieres, në funksion të krijimit të pasurisë objekt analize, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi me problematika burimet e pretenduara për blerjen e saj (pasurisë). Konkretisht, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burime të krijimit të garsonieres, ndërsa në deklaratën për vitin 2007, është shprehur se garsonierja është blerë me të ardhurat prej 15.000 eurosh të përfituara nga bashkëshorti i saj nga emigracioni në Itali. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky deklaram, i vetëm, nuk mund të ketë vlerë provuese në kushtet e mungesës të akteve të tjera që provojnë përfitimin e shumës 15.000 euro dhe *ekzistencën* e saj në vitin 2007. Në parashtrimet kundër rezultateve të hetimit të datës 31.03.2022, subjekti ka pranuar se nuk disponon dokumentacion për këto të ardhura. Për këtë arsye, përjashtohet edhe ndonjë diskutim për ligjshmërinë e të ardhurave nga emigracioni, në kuptim të kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, e për rrjedhojë këto të ardhura nuk mund të pranohen si burim i ligjshëm për krijimin i garsonieres.

14.11. Për efekt të financimit të garsonieres, subjekti pretendon në ankim edhe për të ardhura në vlerën 300.000 lekë, përfituar nga shitja e një automjeti. Ky pretendim bie ndesh me deklaratën *vetting*, në të cilën kjo shumë është deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në Pogradec në vitin 2010, dhe jo për garsonieren, që sipas subjektit është paguar nga viti 2004 deri në vitin 2006. Shtesa e këtyre të ardhurave si burim për garsonieren është pretenduar rishtazi, pas kalimit të barrës së provës mbi rezultatet e hetimit, madje në parashtrimet e dyta kundër rezultateve të hetimit (ato të datës 27.04.2022). Përpos kohës kur ky burim u shtua, në një moment procedural tejet të avancuar -- që në vlerësim të trupit gjykues nuk mund të shihet përveçse si një nevojë e subjektit për të gjetur burime të tjera të ligjshme, në kushtet e pamundësisë për të justifikuar të ardhurat nga emigrimi -- ky burim krijimi pasurie është kontradiktor, parë edhe në aspektin kohor. Konkretisht, përfitimi i të ardhurave nga shitja e automjetit

daton në gusht 2006, disa vite *pas* blerjes së garsonieres në cilindo version të deklaruar (më 01.02.2004 sipas deklaratës për vitin 2004, në vitin 2004 sipas ankimit, më 01.02.2002 sipas DIPP 2007 dhe 2010, apo para datës 20.12.2006, referuar kontratës të shitblerjes të këtij apartamenti me sipërfaqe 25 m<sup>2</sup>). Për rrjedhojë, këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e garsonieres.

14.12. Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se të ardhurat nga shitja e automjetit janë deklaruar në deklaratën për vitin 2006 të *kursyera* e mbartura në cash por jo si të disponuara ende në dhjetor 2009 -- referuar deklaratës periodike vjetore për atë vit, sipas të cilës gjendja e *cash*-it në shtëpi në fund të këtij viti ishte *krijuar* me të tjera burime<sup>35</sup> -- dhe përdorur për apartamentin e analizuar si pasuria e parë. Për rrjedhojë, të ardhurat nga shitja e automjetit nuk u përfshinë as në analizën e kryer në Kolegji në mesin e burimeve të përdorura për blerjen e garsonieres. Mungesa e burimeve të ligjshme për blerjen e garsonieres, si më lart arsyetuar, ka afektuar ligjshmërinë e të ardhurave të realizuara nga shitja e kësaj pasurie, duke prodhuar në vijim një efekt zinxhir në pasuritë e krijuara përmes këtyre të ardhurave. Për sa më sipër analizuar, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson njëjtë si Komisioni, se shuma 1.152.000 lekë nga shitja e apartamentit garsoniere, nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 60 m<sup>2</sup>, në Pogradec.

14.13. Burim tjetër i deklaruar në deklaratën *vetting* për apartamentin objekt analize është referuar edhe kthimi i një pjese të detyrimit nga një huamarrëse. Ndërkaq, në pikën 5.3 të ankimit, vërehet se subjekti i rivlerësimit, ndryshe nga sa ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ, nuk e liston më shumë e kthyer nga kjo huamarrëse, si burim për apartamentin në fjalë. Në kushtet që subjekti nuk provoi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, vlerësimi i Komisionit, për të mos e përfshirë këtë zë të ardhurash në mesin e burimeve të ligjshme të disponuara nga subjekti për efekt të kësaj pasurie, është i bazuar. Trupi gjykues i Kolegjit çmon të nënvizojë se subjekti ka qenë kontradiktore në faza të ndryshme kohore për sa i përket identitetit të huamarrëses, fitimin e interesit si dhe destinacionin e përdorimit të këtyre të ardhurave.

14.14. Konkretisht, në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar dhënien hua të shumës 500.000 lekë kundrejt interesit 10% në vitin 2006 një individ, znj. F. Zh. dhe kthimin e një pjesë të huas. Këto të dhëna bien ndesh me deklaratat periodike vjetore dhe me pyetësonin në aspekte të ndryshme. Konkretisht, në deklaratën për vitin 2006, huamarrëse është deklaruar një person tjetër (znj. E. Z.) ndërsa sipas deklaratës për vitin 2008, huamarrëse është një firmë tregtare (\*\*\* ShPK). Edhe përfitimi i interesit është deklaruar në mënyrë jokonsistente. Në deklaratën *vetting* dhe atë për vitin 2006, është deklaruar interes 10%, në deklaratën për vitin 2008 është deklaruar sikur shuma 252.000 lekë është e gjitha interes (që matematikisht do të ishte mbi 50% e huas) ndërsa në pyetësonë, ky element nuk gjente zbatim dhe huaja ishte dhënë për nevoja personale individuale të saj. Së fundmi, kontradiktat pasqyrohen edhe në drejtim të pyetjes nëse pjesa e detyrimit të kthyer ka shërbyer për pasurinë objekt analize – sikurse deklaruar në deklaratën *vetting* -- ndërkohë që në pyetësonin nr. 2, këto të ardhura nuk specifikohen si burim për likuidimin e kësteve në vitin 2010 dhe 2011. Së fundmi, ndërsa subjekti ka akte të kohës, sikurse deklarata periodike e vitit 2006, që provon ekzistencën e kësaj marrëdhënie, në kushtet që ajo ka vazhduar mbi 10 vjet për shkak të kthimit të pjesshëm, është e pashpjegueshme dhe

---

<sup>35</sup> Në faqen 3 të formularit të deklaratës periodike vjetore për vitin 2009, subjekti ka deklaruar: “Të ardhura të krijuara nga shitja e apartamentit dhe shitja e tokës në pronësi të bashkëshortit (gjendje në shtëpi), 5.500.000 lekë (pesë milionë e pesëqind mijë) lekë”.

me rëndësi në vlerësimin e besueshmërisë fakti që subjekti nuk ka zgjedhur ta formalizojë marrëdhënien në asnjë moment kohor, përpara deklaratës *vetting*. Referimi në pamundësinë objektive në deklaratën *vetting* për shkak se huamarrësja ka ndërruar jetë, nuk mund të mos ngrejë pyetje përse në vitin 2009 (në deklaratën periodike për vitin 2008) huamarrëse paraqitet e bija e saj. Së fundmi, subjekti është e pabesueshme edhe parë në këndvështrim të disponimit të të ardhurave nga kthimi i pjesës së huas në vitin 2008 si burim i kursimeve *cash*, kundrejt disponimit deri në vitin 2010, për efekt të shlyerjes së pagesave për pasurinë objekt vlerësimi.

**14.15.** Burimi tjetër i pretenduar në shkaqet e ankimit, në funksion të krijimit të pasurisë objekt analize, janë të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga avokatia. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se këto të ardhura nuk janë referuar në deklaratën për vitin 2009<sup>36</sup> si pjesë e kursimeve, të cilat subjekti i ka specifikuar nga dy burime të shprehura: shitja e apartamentit dhe e tokës. Për rrjedhojë, duke mbajtur në konsideratë vlerën provuese që kanë deklaratat periodike vjetore në procesin e rivlerësimit, dhe referuar jurisprudencës së Kolegjit ndër vite, për rëndësinë që paraqet identifikimi i burimeve të përdorura kundrejt një pasurie,<sup>37</sup> të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i subjektit nga avokatia nuk u përfshinë në analizën financiare në funksion të krijimit të apartamentit objekt analize, me të njëjtën linjë arsyetimi sikurse edhe të ardhurat e tjera të analizuar më sipër. Ndërsa për efekt të analizës së përgjithshme financiare, ato u konsideruan në vlerat e konfirmuara në mënyrë konsistente nga institucionet kompetente. Pretendimet e potencuara në lidhje me vlerën e këtyre të ardhurave në raport me atë që referojnë aktet e konfirmuara nga institucionet shtetërore, do të shtjellohen në vijim të këtij vendimi, në trajtimin e shkaqeve të ankimit që lidhen me analizën e përgjithshme financiare.

**14.16.** Së fundmi, trupi gjykues mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se blerja e apartamentit objekt kontrolli është revokuar me aktin noterial<sup>38</sup> të datës 30.01.2020 me deklarues bashkëshortin e saj dhe pronarin e truallit/shitësin (z. A. B.). Sipas këtyre pretendimeve, shitësi ka kthyer në vitin 2020 shumat e parapaguara nga subjekti për këtë pasuri. Trupi gjykues e vlerësoi këtë pretendim në drejtim të mungesës së besueshmërisë së veprimeve të subjektit në tërësi. Ky veprim juridik nuk është deklaruar me fillimin e hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit standard, dhënë më datë 20.02.2020, vetëm një muaj pasi pretendohet të jetë revokuar aktmarrëveshja dhe kthyer kësti i parë, por pretendohet në një fazë të avancuar të hetimit administrativ, me përgjigjet e pyetësorit nr. 3. Për më tepër, hartimi i akteve të revokimit të shitjes dhe kthimit të shumave gjatë procesit të rivlerësimit, u vlerësua si një veprim i ndërmarrë për shkak të pamundësisë së subjektit për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti me të ardhura të ligjshme. Nga ana tjetër, këto veprime të kryera në vitin 2020, janë pa efekt dhe nuk mund të shërojnë pamundësinë financiare me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në deklaratën *vetting*.

**14.17.** Për sa më sipër, edhe në Kolegji konfirmohet vlerësimi i Komisionit se subjekti dhe personi i lidhur kanë mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar një pjesë të këstit të parë, prej 2.000.000 lekësh, për blerjen e apartamentit me sip. 60 m<sup>2</sup>, në Pogradec, në vitin 2010, pasi nga analiza financiare rezulton një balancë negative në vlerën (-) 528.643 lekë. Në drejtim të përlllogaritjes së burimeve të

<sup>36</sup> *Ibid.* Shih poshtëshënimin nr. 35, për mënyrën se si është shprehur subjekti verbatim.

<sup>37</sup> Shih ndër të tjera, vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit E. S. nr. 7/2019 (JR).

<sup>38</sup> Nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.01.2020, rikonfirmuar në deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.02.2020, dhe me një deklaratë të thjeshtë dore, datë 08.07.2021, të shitësit A. B.

ligjshme të disponuara kundrejt përfimit të kësaj balance, Komisioni ka pranuar si burim edhe të ardhurat e subjektit nga pagat gjatë vitit 2010 (janar – gusht), ndonëse subjekti nuk i ka referuar ato si burim krijimi për këtë pasuri. Për shkak të garancive procedurale me ankimin, edhe trupi gjykues i Kolegjit i përlogariti këto të ardhura në funksion të kontrollit të analizës financiare të subjektit. Së fundmi, në përmbledhje të analizës së kryer për këtë pasuri, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të mungesës së burimeve të ligjshme, referuar germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

### III. Pretendime në lidhje me automjetin “Mercedes-Benz”, blerë në Gjermani, në dhjetor 2014

15. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *vetting* automjetin objekt shqyrtimi, çmimin e blerjes 13.000 euro dhe vlerën 526.700 lekë të paguar për zhdoganimin e mjetit. Burime krijimi janë deklaruar të ardhurat nga shitja e dy automjeteve të tjera, në shumat 450.000 lekë (nga shitja e automjetit “Benz 250 D”), sipas kontratës së shitblerjes,<sup>39</sup> të datës 12.10.2012, si edhe shumën 900.000 lekë (nga shitja e automjetit “Mercedes-Benz”), sipas kontratës së shitblerjes<sup>40</sup> të datës 16.07.2014. Subjekti ka deklaruar edhe burimet e krijimit për njërin prej dy automjeteve të shitura.

15.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, të pamjaftueshëm dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar blerjen e automjetit, duke u gjendur në kushtet e shkronjës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për shkak të balancës negative prej (-) 1.873.964 lekësh. Komisioni ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaramin në raport me burimet e deklaruara në deklaratën *vetting*, duke shtuar edhe të ardhurat nga puna e saj dhe e bashkëshortit dhe gjendjen *cash* të vitit paraardhës. Komisioni po ashtu është shprehur se subjekti nuk ka provuar pagesën e tatimit për fitimet e krijuara nga shitja e automjeteve më shtrenjtë sesa blerja e tyre. Për pasojë, në analizën financiare, të ardhurat nga shitja e tyre janë konsideruar në vlerë të barabartë me çmimin e blerjes.

15.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni, se bashkëshorti ka shitur automjetet më shtrenjtë sesa i ka blerë, është i gabuar dhe i pambështetur në prova. Automjetet, nga janë krijuar burimet financiare, kanë qenë të përdorura dhe i janë shitur familjarëve shumë të afërt të subjektit dhe që ajo nuk duhet të penalizohet nga shitja më shtrenjtë e një sendi të luajtshëm të mirëmbajtur, në kushtet e ekonomisë së tregut. Për sa i përket detyrimit tatimor, subjekti pretendon se noteri ku janë kryer veprimet, nuk kryen transferimin e pronës pa paguar tatimin, çka prezumon shlyerjen e detyrimeve tatimore, pavarësisht se subjekti nuk disponon mandatin e pagesës së tatimit.

15.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi grupin e mësipërm të pretendimeve dhe pas kontrollit të ushtruar mbi analizën financiare të Komisionit, vëren se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, rezultuan edhe në Kolegji me mungesë burimesh financiare të ligjshme. Edhe duke abstraguuar nga problematika e besueshmërisë së deklarimeve të subjektit, që ngre dyshime për fiktivitet të çmimeve të shitjes së automjeteve në pronësi më herët, e që kanë shërbyer si burim për krijimin e këtij të fundit, subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e mungesës së burimeve për krijimin e kësaj pasurie, në kuptim

<sup>39</sup> Kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.10.2012.

<sup>40</sup> Kontrata nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.07.2014.

të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Në vijim, shtjellohet arsyetimi i Kolegjit për secilin pretendim të potencuar nga subjekti i rivlerësimit në ankim.

15.4. Trupi gjykues i Kolegjit, sikurse edhe Komisioni, konstaton se transaksionet nëpërmjet të cilave subjekti dhe personi i lidhur pasi i përdorin automjetet i shesin ato me fitim, paraqesin elementë të fiktivitetit të çmimeve. Konkretisht, subjekti deklaron se automjeti i parë, blerë në datën 08.03.2001 kundrejt çmimit 200.000 lekë, pasi është përdorur për 11 vjet, i është shitur vëllait të bashkëshortit<sup>41</sup> të subjektit në vlerën 450.000 lekë, ose me fitim mbi dyfishin e vlerës. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen jo bindës këtë rritje të theksuar të vlerës së automjetit, pas një periudhe kaq të gjatë kohore, parë në logjikën e normave të amortizimit që pëson një pasuri e luajtshme. Për më tepër, kryerja transaksionit të shitjes me një person të afërt, nga i cili subjekti dhe personi i lidhur deklarojnë shtim pasuror, ngre dyshime për mungesë besueshmërie.

15.5. E njëjta situatë dhe të njëjtat konstatime gjejnë zbatim edhe për fitimin e gjeneruar nga shitja e automjetit tjetër. Konkretisht, subjekti dhe personi i lidhur kanë blerë automjetin tjetër nga një i afërm (xhaxhai i subjektit)<sup>42</sup>, në datën 17.09.2012 kundrejt çmimit 1.500 euro, dhe pas dy vitesh, në datën 16.07.2014, e kanë shitur këtë mjet kundrejt çmimit 900.000 lekë, transaksion i cili ka gjeneruar një vlerë të shtuar prej kundrejt asaj të shpenzuar prej 332%. Ky fitim sërish në kahun e subjektit dhe personit të lidhur, sfidon logjikën e thjeshtë të amortizimit që pësojnë automjetet pas përdorimit, është i pakuptimtë dhe për rrjedhojë pretendimet e subjektit bëhen të pabesueshme në kushtet që i njëjti automjet, një muaj më pas i është shitur për një vlerë akoma më të lartë, thuajse 1.2 milionë lekë, një institucioni të pushtetit vendor<sup>43</sup>. Qartazi, në vlerën e referuar për blerjen e automjetit apo shitjen e tij, ka një mospërputhje logjike dhe të parametrave të thjeshtë të tregut.

15.6. Trupi gjykues i vlerësoi jo bindëse edhe shpjegimet e subjektit<sup>44</sup> se ky automjet ka qenë thuajse dhuratë dhe se çmimi i shitjes prej 1.500 eurosh ka qenë simbolik e është vendosur për shkak të këmbënguljes së saj për një kundërshtpërblim, në kushtet që nuk gjen pasqyrim në deklaratën e shitjes së nënshkruar nga xhaxhai i saj/shitësi. Për më tepër, nëse gjendja e automjetit ishte shumë e mirë, sikurse pretendon subjekti, nuk shpjegohet as nevoja për ta shitur atë pas dy vitesh, sikurse as nuk shpjegohet këmbëngulja e saj për të paguar një çmim simbolik, ndërkohë që ajo e bashkëshorti kanë fituar një vlerë të konsiderueshme për shkak të asaj që ajo e deklaroi si “thuajse dhuratë”. Së fundmi, nëse automjeti në fjalë do të ishte “thuajse dhuratë” dhe çmimi simbolik -- sikurse pretendohet -- subjekti do të ndodhej në kushtet e “trajtimit preferencial”, rrethanë të cilën kishte detyrimin ta deklaronte në deklaratën periodike për vitin 2012, në bazë të shkronjës “F”, të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Për sa më sipër analizuar dhe duke marrë në konsideratë vlerat e deklaruara të fituara/shpenzuara nga subjekti, tregojnë për veprime fiktive, nëpërmjet të cilave subjekti gjeneron të ardhura të pashpjegueshme edhe pas përdorimit të tyre.

---

<sup>41</sup> Referuar kontratës së shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.10.2012 dhe parashtrimeve të subjektit të datës 27.04.2022, pala blerëse A. M., rezulton të jetë vëllai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

<sup>42</sup> Referuar deklaratës periodike për vitin 2012 dhe parashtrimeve të datës 27.04.2022, pala shitëse M. S. është xhaxhai i subjektit të rivlerësimit.

<sup>43</sup> Referuar dokumentacionit të përcjellë në Komision nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, shoqëria {\*\*\*} ShPK, në datën 05.08.2014 (një muaj pas blerjes së automjetit bashkëshortit të subjektit), ia ka shitur të njëjtin automjet Komunës {\*\*\*}, në vlerën 1.197.600 lekë.

<sup>44</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

15.7. Këto veprime u analizuan dhe vlerësuan si aspekte të mungesës së besueshmërisë dhe si veprime fiktive në funksion të deklarimit të të ardhurave të shtuara. Njëjtë si Komisioni edhe trupi gjykues i Kolegjit, e vlerëson ndryshimin e deklarimit të subjektit në raport me deklaratën *vetting* -- në formën e shtimit të burimeve<sup>45</sup> të padeklaruara si të tilla në deklaratën *vetting* dhe as në DIPP-në e vitit 2014 -- si një përpjekje të saj, për të përmirësuar situatën financiare negative të rezultuar në mbyllje të hetimit administrativ për këtë pasuri. Konkluzioni i mësipërm përforcohet edhe nga fakti që në ankim, subjekti zgjedh të heshtë për sa më sipër, duke potencuar vetëm për *fiktivitetin* e çmimeve të shitjes dhe për aspektin e detyrimeve tatimore mbi fitimin.

15.8. Në vazhden e kundërthënieve të subjektit, trupi gjykues vëren që, ndërsa në ankim ajo nënkupton se detyrimet duhet të jenë shlyer – meqenëse noteri ku janë kryer veprimet, nuk kryen transferimin e pronës pa paguar tatimin – në pyetësorë dhe në parashtrimet kundër rezultateve të hetimit, subjekti ka potencuar se ajo nuk ka pasur detyrim për pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjeteve, pasi ato nuk klasifikohen në grupin e të ardhurave të tatueshme, në kuptim të legjislacionit tatimor. Duke abstraguuar nga kontradiktat e pretendimeve të subjektit, trupi gjykues i Kolegjit çmon të sjellë në vëmendje se, ndonëse analiza financiare e kryer nga Komisioni është e bazuar, argumentimi për të cilin nuk janë përfshirë të ardhurat -- detyrimet tatimore për fitimin e gjeneruar -- është i gabuar.

15.9. Arsyetimi ligjor për të cilin Komisioni nuk ka pranuar vlerat e pretenduara nga shitja e automjeteve është i pabazuar në ligj, e konkretisht me përcaktimin e pikës “g”, të nenit 8 të ligjit nr. 8438/1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, shtuar me ligjin nr. 9161/2003, dhe qëndrimet e konfirmuara të Kolegjit<sup>46</sup> sipas të cilave nuk ka vend një interpretim i zgjeruar i kësaj dispozite nën dritën e parimeve kushtetuese<sup>47</sup>. Mungesa e parashikimit në ligj të këtij detyrimi, merr rëndësi në kushtet e paqartësisë lidhur me shkallën tatimore, bazën e tatueshme, mënyrën e pagesës dhe agjentin tatimmbledhës, por edhe në respektim të qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese, në vendimin nr. 16/2008, se: “*Marrëdhëniet e tatim-taksave janë marrëdhënie ligjore detyrimi ndërmjet shtetit dhe tatimpaguesve dhe si të tilla ato mund të përcaktohen vetëm me ligj*”. Pretendimi i subjektit gjatë hetimit administrativ për mospasje të një detyrimi tatimor është në linjë edhe me përgjigjen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve<sup>48</sup>, sipas së cilës, për qëllim të tatimit të të ardhurave personale, neni 8 i ligjit nr. 8438/1998, dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave, nr. 5/2006 i miratuar në zbatim të tij, nuk përfshin dhe/ose citon në mesin e të ardhurave të tatueshme ato që gjenerohen nga shitja e automjeteve për përdorim personal.

15.10. Për sa më sipër, në vijim të konstatimit të mësipërm të Kolegjit se vlerat e deklaruara të fituara/shpenzuara nga subjekti tregojnë për veprime fiktive, nëpërmjet të cilave subjekti gjeneron të ardhura të pashpjegueshme, trupi gjykues vlerëson se argumenti i Komisionit për mospërfshirjen e të ardhurave nga shitja në këtë rast, do të duhej të konsistonte në *fiktivitetin* e transaksioneve të shitblerjes të automjeteve. Përfundimisht, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në lidhje me mundësinë

<sup>45</sup> Në parashtrimet e datës 31.03.2022, subjekti ka listuar si burime: (i) të ardhurat nga puna e subjektit, bashkëshortit dhe djalit të saj në shumën totale prej 1.923.090 lekësh (1.234.794+186.806+501.490); (ii) shumën 900.000 lekë nga shitja e automjetit tjetër në vitin 2014 dhe (iii) pakësimin e gjendjes mjeteve monetare në fillim të vitit 916.414 lekë.

<sup>46</sup> Vendimi i Kolegjit nr. 26, datë 03.07.2023, pika 12.5, marrë ndaj subjektit të rivlerësimit G. Xh.

<sup>47</sup> Neni 155 i Kushtetutës: “Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj. Në këto raste ligji nuk mund t’i jepet fuqi prapavepruese”.

<sup>48</sup> Në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 25.05.2023, drejtuar Kolegjit.

për blerjen e automjetit objekt analize në vitin 2014, kundrejt vlerës 13.000 euro dhe për pagimin tarifës doganore në vlerën 523.700 lekë, në Kolegj u konfirmua *mungesa* e burimeve financiare të ligjshme, në të njëjtën vlerë (-) 1.873.964 lekë.

15.11. Trupi gjykues i Kolegjit, njëjtë si Komisioni, çmon të theksojë që konstatimi i mësipërm qëndron, edhe nëse në analizën financiare përfshihet e gjithë vlera e fituar nga shitja e këtyre automjeteve referuar kontratave përkatëse të shitjes si burim i krijimit të kësaj pasurie, pasi ajo është gjithsesi e pamjaftueshme për të mbuluar shumën 2.347.832 lekë<sup>49</sup> të shpenzuar për automjetin objekt analize. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit, për këtë pasuri, gjendet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

*IV. Pretendime në lidhje me kredinë në shumën 280.000 lekë, marrë nga djali i subjektit, në vitin 2014, pranë një banke të nivelit të dytë*

16. Në rubrikën e detyrimeve financiare të deklaratës së pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me të ardhurat e saj, ka paguar vlerën 200.000 lekë, për shlyerjen e një pjese të kredisë bankare prej 280.000 lekësh, të marrë në datën 12.05.2014 nga i biri. Pagesa ka filluar pas shkëputjes së tij nga puna më datë 01.09.2015. Për llogari të kësaj kredie, bashkëshorti i saj ka paguar shumën 30.000 lekë. Sipas deklaratës së subjektit, detyrimi i mbetur pa shlyer, deri në datën e fillimit të rivlerësimit, është në vlerën 8413,79 lekë. Subjekti nuk deklaroi arsyen e marrjes së kredisë. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit rikonfirmohet edhe nga i biri, në formularin të plotësuar në cilësinë e personit të lidhur me subjektin, pjesë e deklaratës *vetting*.

16.1. Komisioni ka konkluduar se veprimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë kredi, përbëjnë cenim të figurës së prokurores pasi subjekti nuk e ka deklaruar këtë detyrim të të birit në deklaratën për vitin 2014. Formulari “fotokopje e faqes 10 të DIPP 2014”, i depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ<sup>50</sup> në të cilin evidentohet kredia në fjalë, është i ndryshëm me aktin që administrohet nga ILDKPKI-ja ku në rubrikën e detyrimeve të personit të lidhur E. M., nuk figuron e deklaruar kredia e marrë në Alpha Bank, në vlerën 280.000 lekë. Komisioni ka vlerësuar se pas kalimit të barrës së provës<sup>51</sup>, subjekti dështoi të provonte të kundërtën e konstatimit të mësipërm.

16.2. Subjekti i rivlerësimit potencon në ankim se, ndonëse ka dhënë shpjegime e depozituar akte, që provojnë se korrigjimi i akteve është kryer gjatë pyetjes në ILDKPKI, Komisioni nuk e ka mbajtur në konsideratë këtë fakt.

16.3. Në vlerësim të këtij pretendimi, trupi gjykues në Kolegj vlerëson se, në kushtet që ky detyrim ka një vlerë të ulët, subjekti e ka deklaruar atë në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe kredia në fjalë nuk ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie nga subjekti apo djali i saj, pretendimet e subjektit janë

<sup>49</sup> Shpenzimi total i llogaritur nga Komisioni është 2.347.832 lekë, si shuma ekuivalente e konvertimit në lekë të çmimit të blerjes prej 13.000 euro dhe vlerës 526.700 lekë, të paguar për zhdoganimin e mjetit.

<sup>50</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 3.

<sup>51</sup> Pas kalimit të barrës së provës për konstatimin e mësipërm, subjekti i rivlerësimit ka mohuar të ketë dorëzuar një formular të rremë apo të falsifikuar, duke shpjeguar se mosdeklarimi i kredisë në deklaratën periodike për vitin 2014, është konstatuar në datën 02.03.2016, gjatë dhënies së deklaratimeve në ILDKPKI. Në këtë moment, në prani të inspektoreve që e kontrollonte, subjekti ka ripërpiluar faqen nr. 10 të deklaratës, duke pasqyruar kredinë në fjalë, akt të cilin e ka dorëzuar edhe në Komision me përgjigjet e pyetësorit nr. 3. Për të mbështetur shpjegimet e saj, subjekti ka depozituar si provë, procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 02.03.2016.

të bazuara. Edhe në vlerësimin e kryer në Kolegj, shpjegimet e subjektit në hetimin administrativ për mënyrën sesi ajo ka proceduar për të korrigtuar mungesën e deklarimit në deklaratën periodike vjetore, janë të bazuara. Për rrjedhojë, konkluzioni i Komisionit u vlerësua i pabazuar.

#### *V. Pretendimet në lidhje me analizën e përgjithshme financiare*

17. Pasi kreu analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe personi i lidhur kanë një pamundësi financiare në shumën (-) 13.605.682 lekë. Komisioni ka arsyetuar edhe metodologjinë e përdorur për analizën financiare, sipas arsyesimit në pikën 8 të vendimit objekt shqyrtimi.

17.1. Subjekti konteston rezultatin financiar negativ. Sipas saj, ai është pasojë e mospërfshirjes i të gjitha të ardhurave dhe pasurive të krijuara nga njëra anë, dhe i përfshirjes në mënyrë të padrejtë i disa vlerave që në fakt nuk përbëjnë shpenzim. Referuar kontrollit logjik dhe aritmetik të deklarimeve periodike të pasurisë, analizës financiare të bërë nga ILDKPKI-ja dhe analizës financiare të audituesit të saj ligjor të mbi të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara ndër vite, provohet bindshëm burimi i të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për krijimin e pasurive të saj.

17.2. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, në funksion të shkaqeve të ankimit në Kolegj, pas korrigtimeve të kryera për ato shkaqe që u gjetën të bazuara, referuar edhe më sipër, subjekti i rivlerësimit rezultoi me një balancë negative të burimeve financiare të ligjshme në vlerën (-) 7.174.097 lekë. Pavarësisht nga disa korrigjime në analizën financiare, duke pranuar pretendimet e subjektit për të mos ngarkuar si shpenzim vlerën 2.2 milionë lekë në vitin 2008, mos konsideruar vlerën e disa shpenzimeve të kryera me kartë krediti, efekti financiar i të cilave në vitin 2016 ishte minimal, apo pranimin e vlerës së pretenduar nga shitja e vreshtit në dhjetor 2009, analiza financiare mbetet me balancë negative. Sillet në vëmendje që edhe sipas analizës financiare të hartuar nga eksperti kontabël i pajtuar prej asaj vetë (duke pranuar të gjitha pretendimet e saj) subjekti rezulton gjithsesi me bilanc negativ të konsiderueshëm në shumën (-) 6.426.417 lekë, për periudhën 2003 – 2016, për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve me burime financiare të ligjshme. Për rrjedhojë, konfirmohet edhe në Kolegj konstatimi i *mungesës* së burimeve të ligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b”, e ligjit nr. 84/2016. Kjo balancë, më e ulët, është gjithsesi e konsiderueshme.

17.3. Në këtë konkluzion, trupi gjykues çmon të sjellë në vëmendje se pretendimi i subjektit se Komisioni ka “denaturuar” rezultatin e analizës financiare dhe burimin e mbulimit të shpenzimeve me të ardhura në disa vite, bazuar në argumentimin e saj për *cash-in* e deklaruar ndër vite është i pabazuar. Subjekti kërkon që përlllogaritja të kryhet me pikënisje gjendjen e deklaruar në ILDKPKI “në datën 01.01.2003”<sup>52</sup>, duke i shtuar të ardhurat e dokumentuara për çdo vit dhe zbritur pagesat e dokumentuara e shpenzimet e tjera. Sipas subjektit, rezultati sipas kësaj llogaritjeje, do të tregonte mjetet monetare që ka deklaruar në bankë dhe në banesë.

17.4. Ky pretendim nuk gjen mbështetje në ligj dhe në akte dhe ka gjetur arsyetim të përsëritur e të konsoliduar në vendime të mëparshme të Kolegjit.<sup>53</sup> Në këto kushte, trupi gjykues çmon vetëm të

<sup>52</sup> Deklarata e parë për efekt të ligjit nr. 9049/2003 mban datën 31.03.2004. Presumohet se subjekti ka shkruar datën e referencës gabim.

<sup>53</sup> Shih vendimet e Kolegjit nr. 19 /2019 (JR), datë 26.07.2019, paragrafi 84; nr. 31/2021(JR), datë 12.10.2021, paragrafi 25.2; vendim nr. 8/2019 (JR), datë 16.04.2019; paragrafi 43; vendim nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019, paragrafi 32.5;

rikonfirmojë arsyetimet e mëparshme, duke shtuar në rrethanat konkrete edhe që, *së pari*, vlera e likuiditeteve *cash*, që deklarohet në deklaratat periodike të pasurisë, nuk mund të pretendohet se plotësohet në mënyrë të hamendësuar. Deklarimi i kursimeve duhet të pasqyrojë gjendjen faktike në datën 31 dhjetor të vitit të deklarimit. Ndryshe nga sa pretendon subjekti, mbajtja *mend* apo mbajtja e evidencave, deri në deklarimin *vetting*, nuk ka qenë e nevojshme. Në kushtet që subjekti ka pasur detyrimin për deklarim që prej vitit 2003, mbështetur në ligjin nr. 9049/2003, ajo duhet të deklaronte ndryshimet e pasurive, përfshirë edhe kursimet jashtë sistemit bankar në formën e likuiditeteve *cash*. E vetmja llogaritje që mund të ketë qenë e nevojshme prej saj është ndryshimi (shitesë/pakësim) i gjendjes së likuiditeteve mes fundviteve. Edhe kjo përllogaritje nuk mund të bëhet me hamendësim, në kuptim të ligjit, në kushtet që në vitin paraardhës dhe vitin korrent deklarohen shifra konkrete.

17.5. Në formularin e deklaratës së pasurisë kërkohet të përshkruhen hollësisht ndryshimet, në zbatim të nenit 4, germa “d” e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, që parashikon: [...] *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë [...] brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...].* Për rrjedhojë, gjendja e likuiditeteve *cash* apo kursimet e shtuara kësaj gjendjeje nuk mund të provohen ndryshe në rivlerësim përveçse me deklaratat periodike, si i vetmi dokument i krijuar në kohën që pretendohet krijimi i kësaj pasurie që mund ta provojë atë. Nën dritën e këtyre përcaktimeve ligjore, Komisioni ka përfshirë në analizën financiare vlerat e likuiditeteve *cash*, jo mbi bazën e llogaritjeve të kryera prej tij, por sikurse ato janë deklaruar nga ana e subjektit.

17.6. *Së dyti*, nga aktet rezulton se analiza financiare e Komisionit bazohet në gjendjen e likuiditeteve *cash* sipas deklaratave periodike dhe jo sipas deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit. Për shkak të paqartësisë së deklaratave periodike të hartuara nga subjekti, asaj i është dhënë mundësia nëpërmjet pyetësorit nr. 2, të qartësojë panoramën mbi gjendjen dhe ndryshimet në likuiditetet *cash* në fund të çdo viti, si dhe përdorimin e tyre për periudhën 2003 – 2017. Trupi gjykues vëren se përgjigja e subjektit nuk ka qenë e plotë. Ajo nuk ka dhënë shpjegime për ndryshimet në likuiditetet *cash* dhe përdorimin, por vetëm për gjendjen e tyre në fund të çdo viti.

17.7. Kërkimi i subjektit, për të përllogaritur të ardhurat e përfituara nga aktiviteti privat i bashkëshortit në vitet 2012-2013, në shumën 2.584.800 lekë për secilin vit, është e pabazuar. Konkretisht, subjekti kërkon që të ardhurat e bashkëshortit për këto vite, të përllogariten sipas shkresës së mëparshme të Bashkisë Elbasan drejtuar ILDKPKI-së përkundër shumave 258.480 lekë të pasqyruar për këto dy vite në shkresën e dytë.<sup>54</sup> Në kushtet që të gjithë deklaratimet e subjektit për dy vitet e pretenduara, referojnë të ardhura në shumat 258.480 lekë dhe 440.000 lekë<sup>55</sup>, përfshirë edhe përgjigjen nr. 16.16, të pyetësorit standard nr.1, apo librin e shitjeve për vitet 2012 dhe 2013, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se totali i shitjeve me TVSh, nuk e kalon kufirin e xhiros vjetore prej 2.000.000 lekësh, ky pretendim mbetet tërësisht deklarativ. Edhe vërtetimi i sipërcituar Bashkisë Elbasan, mbi të cilin subjekti mbështet

---

vendim nr. 29/2019 (JR), datë 08.11.2019, paragrafi 31; vendim nr. 1/2020 (JR), datë 15.01.2020, paragrafi 50; vendim nr. 11/2019 (JR), paragrafi 27; vendim nr. 19/2019 (JR), paragrafët 84-85.

<sup>54</sup> Përkatësisht shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 21.07.2017, kundrejt asaj nr. {\*\*\*} prot., datë 21.02.2022.

<sup>55</sup> Referuar deklaratimit, përkatësisht me “vërtetim” dhe me “kopje e librit të shitjeve”.

kërkimin e saj, ka informacion për shlyerjen e detyrimeve për vitet 2008 – 2011, nuk ka informacion për dy vitet e pretenduara, 2012 dhe 2013. Pasi i është kërkuar në pyetësonin nr. 3, të vërtetojë me dokumentacion nga Drejtoria e Tatimeve të ardhurat *neto* të bashkëshortit nga avokatia për këto dy vite, subjekti ka zgjedhur të heshtë/të *mos* japë shpjegim. Ajo ka referuar vlerat e taksave të paguara, të cilat sipas shpjegimit kanë qenë në shumën 258.480 lekë për vitin 2012 dhe 256.480 lekë për vitin 2013. Nga sa më sipër, rezulton se subjekti ka *ndryshuar* deklaratimet e mëparshme, duke referuar në hetimin administrativ si taksë vlerat që në vitet përkatëse janë deklaruar si e ardhur. Në kushtet që në të dy aktet e dërguara nga Bashkia, në vitet 2012 – 2013, bashkëshorti i subjektit, për efekt të përllogaritjes së taksave, është trajtuar me xhiron *nën* 2 milionë lekë, pretendimi i subjektit është në kundërshtim me aktet zyrtare në kushtet që ajo kërkon përllogaritje të fitimit *neto* përtej kufirit të sipërm të xhiros së vetë-deklaruar prej tij. Sa sipër, ndryshimi i deklaratimeve në fazën finale të hetimit administrativ, vlerësohet nga trupi gjykues i Kolegjit si një përpjekje e subjektit për të gjetur burime të ligjshme të cilat do të përmirësonin rezultatet e analizës financiare.

17.8. Subjekti pretendon se në analizën financiare të vitit 2016, nuk duhet të përfshihen si zë më vete, shpenzimet në shumën 112.668 lekë, për blerjet e kryera me kartë brenda dhe jashtë vendit. Këto janë shpenzime për artikuj ushqimorë e veshmbathje, të cilat janë të përfshira në zërat e konsumit familjar sipas llogaritjeve të INSTAT-it. Në përgjigje të këtij pretendimi, trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit,<sup>56</sup> vlerëson se shpenzimet e kryera me kartë, janë shpenzime të veçanta të kryera nga subjekti, dhe si të tilla, nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet jetike të llogaritura nga INSTAT-i, pasi në këto të fundit përfshihen ato shpenzime bazike që kryhen në vijimësi nga çdo shtetas shqiptar, pa përfshirë ato specifike e të veçanta. Kolegji *nuk* përfshiu në analizë financiare pagesën e datës 03.10.2016, për blerje brenda vendit në vlerën 19.830 lekë, me shitës shoqëria “{\*\*\*}” në Tiranë, duke e vlerësuar këtë shpenzim si pjesë të shpenzimeve minimale për konsum. Megjithatë, referuar bilancit negativ të vitit 2016, mospërfshirja e këtij shpenzimi në analizën e përgjithshme financiare, jo vetëm që nuk e shëron atë, por ka një ndikim të papërfillshëm.

17.9. Pretendimet për të mos konsideruar si shpenzim shumën 2.2. milionë lekë të tërhequr nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2008, dhe për të përfshirë në analizën financiare të vitit 2009 shumën 4.2 milionë lekë, të përfituar nga shitja e tokës *vreshtë*, u pranuan në Kolegji sipas arsytimit të bërë në këtë vendim në lidhje me shkakun ankimor për pasurinë “apartament banimi 3+1”, në lagjen “{\*\*\*}”, Elbasan.

17.10. Trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të pabazuar pretendimin e subjektit për t’i ndarë periudhat e analizës financiare i rivlerësimit *si para dhe pas* fillimit të detyrës, duke marrë në konsideratë që gjatë periudhës 2003 – prill 2005, ajo ka qenë Oficere e Policisë Gjyqësore. Vlera e pamjaftueshmërisë financiare të burimeve të ligjshme si edhe fakti se që prej vitit 1985 deri në vitin 2005, subjekti në mënyrë të hershme e të pandërprerë ka qenë jo thjesht një funksionare publike, por funksionare e sistemit të

---

<sup>56</sup> Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin nr. 8/2021 (JR), paragrafi 30, që i përket s. r. I. M., shprehet se: [...] Shpenzimet bazike që përllogariten sipas INSTAT-it, janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme që përfshin edhe nivelin e varfërisë, bazuar në shpenzimet e përditshme jetike të qëndrimit dhe jetesës në Republikën e Shqipërisë dhe pagat mujore të këtuashme. Ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore. [...]

drejtësisë<sup>57</sup>, respektivisht në detyra të së njëjtës rëndësi për hetimin penal, janë rrethana që e bëjnë njësoj të qenësishëm standardin e kërkuar nga një magjistrat, për integritet<sup>58</sup>. Por edhe duke abstraguuar nga sa më lart arsyetuar, e po ashtu edhe nga fakti që pretendimi i ngritur në ankim nuk gjen zbatim as në analizën financiare të ekspertit kontabël të pajtuar prej vetë subjektit -- e cila nuk është hartuar e copëzuar por e plotë për të gjithë periudhën 1985 – 31.12.2016 -- ky pretendim mbetet i pambështetur edhe në versionin alternativ sipas ndarjes së potencuar. Edhe në versionin e analizës financiare me periudha të ndara, subjekti rezultoi me mungesë të burimeve financiare për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën (-) 982.971 lekë para fillimit të detyrës dhe në vlerën (-) 6.358.385 lekë pas fillimit të detyrës. Pra, dukshëm, ndarja e analizës sipas pretendimeve të subjektit, jo vetëm që nuk shëron rezultatin negativ, por ka një ndikim fare të vogël në zbutjen e tij.

18. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit *ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme*, për të justifikuar krijimin e pasurive të deklaruara dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Ajo ka qenë kontradiktore, në mënyrë të theksuar për burimet e krijimit të pasurive, në kundërshtim me detyrimin sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016. Këto rrethana e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e *deklarimit të pamjaftueshëm* për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, me pasojë aplikimin e masës disiplinore të *shkarkimit nga detyra*.
19. Nga ana tjetër, ndonëse është i drejtë konstatimi i Komisionit, se subjekti ka vështirësuar procesin e kontrollit të pasurive nëpërmjet deklarimeve me kontradikta e kundërthënie të përsëritura, trupi gjykues e vlerësoi këtë aspekt si një tregues me peshë në konkluzionin përfundimtar për mungesën e besueshmërisë së subjektit të rivlerësimit, në kontrollin e kriterit të pasurisë. Në kushtet që trupi gjykues konfirmoi deklarin të pasaktë e të pamjaftueshëm të subjektit të rivlerësimit, si pasojë e të cilit ajo *nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë*, kontradiktat e theksuara në shpjegimet e saj u bënë pjesë integrale, sikurse referuar më sipër, e analizës kundrejt qartësisë të krijimit të pasurive. Për rrjedhojë, u vlerësua e panevojshme një analizë e veçantë në kontekstin e cenimit të besimit të publikut apo vlerësimit tërësor, në rrethanat konkrete dhe u gjend i padrejtë qëndrimi i Komisionit në këtë drejtim.
20. Në përmbledhje të sa më sipër, nën dritën e dispozitave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit *nuk arrin nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë dhe vendimi nr. 534, datë 23.05.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i bazuar në fakte e në ligj dhe duhet të lihet në fuqi*.

### PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

<sup>57</sup> Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë që prej datës 01.09.1985, ku ka ushtruar funksionin si Hetuese, duke u emëruar në datën 01.04.2005 si prokurore.

<sup>58</sup> Shih <https://hudoc.echr.coe.int/eng/?i=001-208053>, paragrafi 407, vendimi i GjEDNj-së në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, referuar edhe në çështjen “A. Zeneli kundër Shqipërisë”, në <https://hudoc.echr.coe.int/?i=001-247590>.

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 534, datë 23.05.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Elveta Stafa (Murra).
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 03.04.2025, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Mimoza TASI**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*